



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.2.2024, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik.””.

3. Shqyrtimi i dekretit nr.10, datë 13.01.2023 “Për kthimin e ligjit nr. 93/2022 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë””.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Jurgys Çyrbja, Toni Gogu, Damian Gjiknuri, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Eduard Ndreca, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Plarent Ndreca, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Arkend Balla, Gledis Çeliku, Ermonela Felaj, Gerta Duraku, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Dhurata Çupi, Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Klevis Xhoxhi, Enkelejd Alibeaj dhe Dashnor Sula.

Mungojnë:

Bledion Nallbati, Gazmend Bardhi, Elda Hoti, Fatmir Mediu, Greta Bardeli, Oerd Bylykbashi, Erisa Xhixho dhe Saimir Korreshi.

Të ftuar:

Klajd Karameta – zëvendësministër i Drejtësisë

Elsonida Rama – drejtoreshë e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të
Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Elisa Spiropali – ministre i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Elira Kokona – këshilltare e Jashtme pranë Kryeministrit

Reida Kashta – drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Prokurimit Publik

Valbona Lusha – sekretare e Përgjithshme në Presidencë

Ilirjan Rusmajli – këshilltar i Presidentit

Erjola Shia – drejtoreshë e Shërbimeve Juridike në Presidencë

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka – Kolegë, mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e sotme me rend dite sipas njoftimit. Kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes është i pranishëm.

Sot në rendin e ditës kemi tri çështje: shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”; shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik.””, si dhe shqyrtimin e dekretit nr.10, datë 13.01.2023 “Për kthimin e ligjit nr. 93/2022 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë””.

Fillojmë me çështjen e parë të rendit të ditës, me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e të drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Plarent Ndreca.

Të ftuar nga Ministria e Drejtësisë kemi *online* zotin Klajd Karameta, zëvendësministër dhe zonjën Elsonida Rama, drejtoreshë e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Zoti Karameta, fjala për ju, për të na bërë një prezantim të projektligjit.

Teknika, ju lutem, mundësojini fjalën zotit Karameta.

Klajd Karameta – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të angazhimit të ndërmarrë nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për vijimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e drejtësisë, në datën 20 qershor 2022 ministrat e drejtësisë të të dy vendeve kanë nënshkruar një deklaratë, përmes së cilës janë angazhuar, ndër të tjera, për hyrjen në reciprocitet në fushat e avokatisë dhe ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Për këtë qëllim, si rezultat i punës me kolegët e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, por edhe me kontributin e kolegëve tanë të avokatisë dhe ndërmjetësimin të të dyja vendeve, është

përgatitur marrëveshja “Për njohjen e të drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, që sot paraqitet para jush për shqyrtim.

Me anë të kësaj marrëveshjeje njihet e drejta e ushtrimit të profesionit të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë për personat që e kanë fituar këtë të drejtë në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas.

Me bashkëpunimin e ngushtë të Dhomës dhe Odës së Avokatëve dhe ndërmjetësve në republikat përkatëse, do të mundësohet që të dyja profesionet të mos shkojnë më në kufijtë e tjerë, si dhe qytetarët e Kosovës të mos shihen më si shtetas të huaj në këtë drejtim. Çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë dhe i Republikës së Kosovës do të ketë mundësinë të zgjedhë profesionistin që ai vlerëson për ta përfaqësuar në gjykatë apo për të zgjidhur mosmarrëveshjet pa iu nënshtruar barrierave kufitare, pavarësisht nëse çështja paraqitet para organeve të Shqipërisë apo të Kosovës.

Marrëveshja garanton edhe cilësinë e shërbimit që do të ofrohet nga avokatët dhe ndërmjetësit, duke u mundësuar dhomave dhe odave mekanizma kontrolli, me qëllim që qytetarët të kenë mundësinë të marrin shërbimin më të mirë.

Avokatit dhe ndërmjetësit, të cilit i njihet e drejta e ushtrimit të profesionit në njërin vend do të gëzojë të njëjtat të drejta edhe në vendin tjetër, sipas legjislacionit të atij vendi, njëjloj si edhe profesionistët që e kanë fituar titullin në atë vend.

Për këtë qëllim marrëveshja parashikon se avokati ose ndërmjetësi, që kërkon ta ushtrojë profesionin e tij në vendin tjetër, duhet të vërtetojë se zotëron njohuri të mjaftueshme të së drejtës të zbatueshme në atë vend. Për të vërtetuar zotërimin e njohurive avokatit ose ndërmjetësit i njihen 3 forma, që ai mund të zgjedhë, siç janë: kalimi me sukses të një provimi për testimin e njohurive; ndjekja e një trajnimit të organizuar nga dhomat ose ushtrimi i profesionit në mënyrë të rregullt dhe efektive, në bashkëpunim me, përkatësisht, një studio avokatie ose ndërmjetëse në territorin e vendit tjetër, për një periudhë jo më pak se 6 muaj.

Ndërkohë, kur avokatit ose ndërmjetësit, që kërkon ta ushtrojë profesionin në vendin tjetër vetëm në raste individuale, i njihet kjo e drejtë me miratimin e organit të parashikuar nga legjislacioni i vendit përkatës, në Republikën e Shqipërisë miratimi në këtë rast do të jepet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë.

Marrëveshja vlerësohet të ketë impakt pozitiv për profesionistët në fushën e avokatisë dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për qytetarët në të dyja vendet, si dhe për dhomat profesionale që do të duhet të intensifikojnë bashkëpunimin me njëra-tjetrën.

Ratifikimi i marrëveshjes nga Kuvendi shënon një hap të rëndësishëm, pasi hap rrugën për njohjen edhe të profesioneve të tjera, duke eliminuar pengesat ligjore apo procedurale, me qëllim unifikimin dhe krijimin e një tregu të përbashkët të profesioneve të lira në të dyja vendet tona. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Karameta!

Në fakt, kjo është një marrëveshje e shumëpritur ndërmjet dhomave të avokatëve dhe ndërmjetësve të të dyja vendeve. Gjithashtu, është një lajm i mirë pasi ne si Komision i Ligjeve kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Komisionin e Çështjeve Ligjore të Kosovës dhe kjo ka qenë një kërkesë e vazhdueshme për ta ndjekur të dyja komisionet e të dyja kuvendeve, si një çështje që jo vetëm lehtëson avokatët, por edhe ndihmon qytetarët më së pari.

Zoti Ndreca, në cilësinë e relatorit, keni fjalën për projektligjin.

Plarent Ndreca – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Ashtu siç e parashtroi edhe zoti Karameta, kjo është një marrëveshje e miratuar nga Këshilli i Ministrave, që, në fakt, sjell një hap shumë pozitiv në fushën e bashkëpunimit ndërmjet mbrojtjes ligjore të të dyja vendeve.

Unë mendoj se është një marrëveshje, siç e thatë edhe ju, e shumëpritur, pasi u krijon mundësinë të dyja palëve profesionale në fushën e avokatisë, që të mbrojnë të drejtat e klientëve të tyre të së njëjtës kombësi, pavarësisht faktit se janë në shtete të ndryshme. Unë e kam parë me kujdes marrëveshjen dhe mendoj se e gjithë marrëveshja e miratuar nga të dyja qeveritë është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare”, ndaj do ta konsideroja si një marrëveshje që duhet të kalohet nga komisioni ynë për t’iu nënshtruar më pas votimit në seancë plenare.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Ndreca!

A keni pyetje, kolegë? Në rregull!

Kam unë një pyetje për zotin Karameta, nëse po më ndjek.

Pyetja ime ka lidhje me detyrimet që kanë avokatët apo ndërmjetësit, si në Shqipëri dhe në Kosovë. A zbatohet parimi i barazisë në detyrimet e barazisë në të drejta? A është marrë në konsideratë kjo gjë në këtë marrëveshje?

Klajd Karameta – Zonja kryetare, marrëveshja parashikon që më vonë do të ketë edhe marrëveshje teknike lidhur me këtë gjë. Pra, pas miratimit të kësaj marrëveshjeje që ne kemi përpara, vetë dhomat e avokatisë dhe ndërmjetësimi do të rregullojnë procedura të caktuara. Këtu kam parasysh kryesisht procedurën e disiplinimit, që është shumë e rëndësishme në rastet kur do të kemi procedime të referimeve nga avokatët e të dyja vendeve, por këto do të përcaktohen nga dhomat me marrëveshje të ndërsjellë, për arsye se avokatët do t'i nënshtrohen legjislacionit të origjinës së tyre në këtë rast. Po marr, për shembull, procesin e disiplinës, ku avokatët shqiptarë, që do të ushtrojnë profesionin në Kosovë apo avokatët e Kosovës, që do të ushtrojnë profesionin në Shqipëri, disiplinën do ta kenë te vendi mëmë, le të themi, pra andej nga ata vijnë. Këto janë detaje teknike, që të dyja dhomat do t'i bëjnë më pas me marrëveshje të caktuara, pasi të miratohet kjo marrëveshje kuadër që ne kemi përpara, për njohjen e të drejtës për ta ushtruar profesionin në vendet e tjera.

Njëkohësisht, më lejoni të theksoj se marrëveshje të kësaj natyre ekzistojnë në të gjitha vendet e Bashkimit Europian, pra lejohet në parim për profesionistë të shumë fushave dhe këtu kam parasysh avokatinë, por edhe ndërmjetësimin, që të ushtrojnë profesionin edhe në territorin e vendeve të tjera. Nga ky aspekt kjo është një praktikë e mirë, pra është një praktikë që u lejohet të gjithë këtyre profesionistëve të vendeve të BE-së dhe kriteri kryesor, që vlen të zbatohet dhe të mbahet në vëmendje, është kriteri i profesionalitetit, që do të thotë se krahas një problematike që një profesionist si avokati ose ndërmjetësi ta ushtrojë profesionin e tij në vende të tjera, me kushtin që ai të njohë rendin juridik të territorit ku ai do të ushtrojë profesionin.

Këtij parimi i është dhënë vëmendja e caktuar dhe, siç e theksova edhe në fjalën time, janë parashikuar tri raste për avokatë ose ndërmjetës të ndryshëm, të cilët do të kenë dëshirën të punojnë në territoret e vendeve respektive. Ata që janë të profesionit të avokatit e dinë edhe më mirë që ka disa situata, ku mund të ketë avokatë që pikën e rëndësës së punës së tyre duan ta përcjellin komplet në vendin tjetër, ndaj për ta është parashikuar kryerja e një provimi. Provimi i avokatisë ose i ndërmjetësit organizohet nga dhomat përkatëse në mënyrë që të merret kualifikimi për të hyrë në profesion. Pra, në qoftë se një avokat i Kosovës rezulton se 60% apo 70% të aktivitetit të tij duhet ta ushtrojë në Shqipëri ose një avokat i Shqipërisë mendon se një

pjesë të madhe të aktivitetit do ta ushtrojë në vendin respektiv, kjo do të shoqërohet edhe me nevojën reale praktike që ta njohë mjaft mirë legjislacionin e vendit ku do ta ushtrojë profesionin, në mënyrë që t'u bëjë punë njerëzve, së pari, dhe, së dyti, të mos bëjë gabime që mund të çojë në masë disiplinore ndaj tij. Pra, kësaj i është dhënë zgjidhja duke u bërë provimi përkatës pranë dhomës përkatëse të avokatëve ose të ndërmjetësve.

Ndërkohë, kemi një situatë tjetër, kur një avokat apo një ndërmjetës në vendet respektive do të ndjekë vetëm një praktikë ose do të ndjekë një numër shumë të kufizuar praktikash. Edhe për këtë është parashikuar të kemi një strukturë të tillë, që këta njerëz duhet ose të marrin leje pranë dhomës përkatëse, ose pranë Ministrisë së Drejtësisë të vendit përkatës, në qoftë se duan të kryejnë, për shembull, vetëm një ose dy punë në vit. Pra, në këtë rast kërkohet leja pranë organeve përkatëse.

Gjithashtu, parashikohet edhe rasti i ndërmjetëm, kur avokatët ose ndërmjetësit duan të kenë shpesh punë në territorin e vendit të caktuar dhe këtu është menduar të marrin pjesë në një trajnim 6-mujor pranë dhomave përkatëse. Këto pastaj do të përcaktohen nga dhomat me marrëveshje të detajuar se ku do të bëhet ky trajnim, cilat module do të ndjekin, cilat lëndë do të ndjekin, në të Drejtën Civile, në të Drejtën Publike apo në të Drejtën Penale e kështu me radhë. Pra, në këtë mënyrë është menduar të ofrohet një set me instrumente që në secilën situatë ku profesionistët e ligjit do të duhet të angazhohen, qoftë për disa çështje të veçanta, qoftë edhe për një çështje në vit, pra për secilin rast ne të kemi mundësinë të garantojmë ruajtjen e standardit, që ata të njohin rendin juridik të vendit përkatës ku do të veprojnë, por, njëkohësisht, të ruajmë edhe interesin e qytetarit, që ai të mos bjerë pre e ndonjë suate ku avokatët japin këshillime pa ditur se për çfarë flasin. Me dy fjalë, kjo është përgjigjja.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Karameta!

Në fakt, në nenin 7 “Marrëveshjet teknike” thuhet: “Dhomat përkatëse të palëve lidhin marrëveshje teknike për rregullimin e hollësishëm të çështjeve të mëposhtme: a) anëtarësia, e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese të Dhomës/Odës, si dhe pagesa e kontributit të anëtarësisë; b) deklarimi i të dhënave sipas legjislacionit të vendit ku ushtron veprimtarinë dhe çdo ndryshim i tyre; c) sigurimi i përgjegjësisë profesionale; ç) ndjekja e trajnimeve vazhduese; d) procedimi disiplinor dhe masat disiplinore deri në heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit në atë vend, si dhe mënyra e njoftimit të tyre; dh) mënyra e njoftimit dhe komunikimit të pezullimit ose heqjes së titullit.

2. Marrëveshjet teknike, sipas pikës 1 të këtij neni, lidhen sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje.”

Këto janë rregullat për avokatët edhe për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, por që, në fakt, garantojnë cilësinë e shërbimit dhe përgjegjshmërinë e këtij shërbimi ndaj qytetarëve. Kjo marrëveshje, në kudër edhe të marrëveshjes së bashkëpunimit që ka Komisioni ynë i Ligjeve me Komisionin përgjegjës të Ligjeve në Kosovë, do të jetë pjesë e veprimtarisë monitoruese të të dyja kuvendeve për sa i takon zbatimin të marrëveshjeve midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Po, zoti Ndreca.

Plarent Ndreca – Dua të sqaroj diçka.

E para, merakun që ju kishit dhe që iu drejtuat me pyetje zotit Karameta është në lidhje me proporcionalitetin dhe besoj se sapo e sqaruat duke iu referuar nenit 7. Ajo që unë kam kuptuar nga marrëveshja, në ndryshim nga çfarë tha zëvendësministri, është se procedimi disiplinor do të bëhet në bazë të legjislacionit, ku avokati shkon për të ushtruar profesionin. Pra, nëse një avokat shqiptar merr të drejtën për të ushtruar profesionin në Dhomën/Odën e Avokatisë Kosovë, atje do t'i nënshtrohet edhe procedimit disiplinor, sipas rregullave të asaj ode dhe jo në Dhomën e Avokatisë Shqiptare. Unë kështu e kam kuptuar, duke iu referuar nenit 7 të këtij projektligji. Pra, praktikisht, me këtë marrëveshje në mënyrë krejt të natyrshme secili prej avokatëve, për sa kohë pranon të bëhet anëtar i dhomës respektive, do të pranojë edhe rregullat e organizmit dhe procedimit disiplinor sipas rregullave të secilës dhomë apo odë. Ky besoj është edhe qëllimi i marrëveshjes, sipas asaj që kam lexuar unë, pavarësisht se zoti Karameta më duket se e sqaroi ndryshe.

Klotilda Bushka – Kam përshtypjen se të njëjtën gjë thatë të dy, por shpjegimi më i qartë jepet te neni 7. Kështu që në nenin 7 është ...

Plarent Ndreca – Mua m'u duk sikur tha që do t'i nënshtrohet procedimit disiplinor të dhomës ku bën pjesë në origjinë.

Klotilda Bushka – Në nenin 7, shkronja “d”, thuhet: “d) procedimi disiplinor dhe masat disiplinore deri në heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit në atë vend, si dhe mënyra e njoftimit të tyre”, që nënkupton vendin ku kryhet shkelja, sipas rregullave të atij vendi dhe kjo do të jetë pjesë e rregullimit të marrëveshjeve teknike ndërmjet odave.

Zoti Karameta, mund të bëni një sqarim të fundit dhe fjalën më pas do ta kenë kolegët për pyetje.

Klajd Karameta – Unë e theksova se do të lidhen marrëveshje teknike ndërmjet dy dhomave për pjesën e gjërave që do të ndodhin pas miratimit të kësaj marrëveshjeje. Në gjykimin tim nuk ka sesi një organ të ta japë licencën dhe një tjetër të ta heqë. Në qoftë se avokati kosovar e ka marrë licencën në Kosovë, nuk ka sesi t'ia heqë Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë.

Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë përcakton shkeljen në bazë të marrëveshjes teknike që lidhet me Odën e Avokatisë së Kosovës dhe më pas është Oda e Avokatisë së Kosovës ajo që ta jep dhe ta heq licencën. Kështu e kuptoj unë, të paktën, kështu është edhe praktika standarde në vendet europiane. Pra, organi që ta jep licencën ka të drejtën edhe të ta heqë licencën dhe nuk ka se si njëri ta japë dhe tjetri ta heqë. Gjithsesi, këto janë çështje që do të zgjidhen me marrëveshjet teknike, që do të krijojnë të dyja dhomat me njëra-tjetrën.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Karameta!

Për sa kohë janë çështje që rregullohen në marrëveshjet teknike ndërmjet dy dhomave, neve na intereson, pa diskutim, që secila dhomë të zbatojë legjislacionin që ka dhe detyrimet e kësaj marrëveshjeje. Ajo që vlen të theksohet është se qytetarëve si në Shqipëri, si në Kosovë, duhet t'u jepen shërbime cilësore dhe të përgjegjshme nga avokatët e cilitdo vendi qofshin ata dhe me standarde të unifikuara. Pra, ky është interesi publik që ne mbrojmë këtu, kështu që për sa kohë marrëveshjet teknike janë për të rregulluar këto çështje, mendoj se vetë dhomat do ta gjejnë mundësinë për të arritur standardin më të mirë, siç e kanë edhe vendet e tjera.

Kolegë, a ka pyetje apo diskutime të tjera? Nuk ka.

Atëherë, kolegë, bëhemi gati për votim. Kuorumi i nevojshëm është i pranishëm.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”? Kundër?...

Kolegë, ju lutem, nëse nuk keni mundësi teknike të dilni me video dhe jeni kundër, shkruani “kundër” në grupin e komunikimit *online*.

Votojmë edhe një herë në parim projektligjin. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi, kolegë.

Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi.

Ky projektligj duhet të bëhet gati për në seancë plenare, me lajmin e mirë se do të shtohen aftësitë mbrojtëse të qytetarëve shqiptarë dhe kosovarë në të dyja anët e kufirit dhe se do të përdorin standarde të njëjta në të mirë të interesit publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.02.2024, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020, “Për prokurimin publik.””

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Jurgys Çyrbja, Toni Gogu, Damian Gjikhuri, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Eduard Ndreca, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Plarent Ndreca, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Arkend Balla, Gledis Çeliku, Ermonela Felaj, Gerta Duraku, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Dhurata Çupi, Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Klevis Xhoxhi, Enkelejd Alibeaj dhe Dashnor Sula.

Mungojnë:

Bledion Nallbati, Gazmend Bardhi, Elda Hoti, Fatmir Mediu, Greta Bardeli, Oerd Bylykbashi, Erisa Xhixho dhe Saimir Korreshi.

Të ftuar:

Elisa Spiropali – ministre i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Elira Kokona – këshilltare e Jashtme pranë Kryeministrit

Reida Kashta – drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Prokurimit Publik

Klotilda Bushka – Viojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik””. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore e këtij projektligji do të jem unë.

Ndërkohë, kanë konfirmuar pjesëmarrjen dhe janë *online* zonja Elisa Spiropali, ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; zonja Elira Kokona, këshilltare e Jashtme pranë Kryeministrit dhe zonja Reida Kashta, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Prokurimit Publik. Gjithashtu, *online* është edhe zoti Jonaid Myzyri nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Kolegë, do të presim një sekondë, pasi do të lidhemi me zonjën Spiropali, e cila ishte *online*, por ndoshta ka pasur një defekt teknik.

Mirë se erdhe në komision, zonja Spiropali!

Elisa Spiropali – Përshëndetje, zonja kryetare!

Klotilda Bushka – Fjala për ju, zonja Spiropali, për të bërë një prezantim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik””.

Unë e thashë në fillim se nga Këshilli i Ministrave do të jeni këtu si përfaqësuese për prezantimin e nismës, së bashku me zonjën Kashta, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Prokurimit Publik; zonjën Kokona, Këshilltare e Jashtme pranë Kryeministrit dhe zotin Jonaid Myzyri nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Fjala për ju, zonja Ministre.

Elisa Spiropali – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Propozimi për ndryshime në ligjin “Për prokurimin publik”, që diskutojmë sot, vjen në kuadër të procesit të integritetit, ku konkretisht synohet përafrimi i legjislacionit me dy direktivat e BE-së, si dhe angazhimet e marra në vijim të takimit dypalësh për kapitullin 5 “Prokurimi publik”, të zhvilluar në Bruksel, në kuadër të procesit “*screening*”. Këto ndryshime vijnë për të adresuar disa problematika të dala gjatë zbatimit të ligjit aktual në praktikë, të lidhura kryesisht me organizimin e kuadrit institucional, si dhe me zhvillimin teknologjik të aseteve të ndryshme të procesit të prokurimit, duke futur konceptin e inteligjencës artificiale dhe automatizimit të proceseve në sistemin e prokurimit elektronik dhe ndërveprimin e tij me sisteme të tjera.

Projektligji adreson çështje të organizimit të kuadrit institucional dhe të zhvillimit teknologjik, duke prezantuar koncepte që lidhen me inteligjencën artificiale dhe automatizimin e proceseve.

Përmes këtyre ndryshimeve synohet përmirësimi i prokurimit publik në disa drejtime kryesore.

Së pari, dhe më i rëndësishmi, rritet transparenca dhe eficienta në procedurat e prokurimit. Për arritjen e këtij synimi ky projektligj propozon zhvillimin e teknologjisë dhe të inovacionit në sistemin e prokurimit në disa elemente të procesit, siç është përlogaritja e vlerësimit të kontratës, studimi i tregut, hartimi i specifikimeve teknike dhe vlerësimi i ofertave; prezanton përdorimin e teknologjisë së avancuar të inteligjencës artificiale dhe të proceseve të robotizuara në sistemin dinamik të blerjes dhe ankandit elektronik.

Zhvillimet teknologjike jo vetëm do të rritin transparencën, por do t'i lehtësojnë operatorët ekonomikë duke ulur kohën e shpenzuar dhe kostot e mëparshme për dorëzimin e dokumentacionit të noterizuar për çdo procedurë. Dokumentet do të gjenerohen automatikisht përmes ndërveprimit të sistemeve.

Në këtë akt është vlerësuar normimi në ligj i konceptit të sistemit elektronik të ankesave dhe i sistemit të menaxhimit të zbatimit të kontratave si sisteme të reja që mundësojnë zhvillimin me mjete elektronike të procesit të rishikimit administrativ dhe fazës së menaxhimit të kontratave publike.

Përcaktohet koncepti i “pasaportës së prokurimit publik” dhe i dosjes virtuale të operatorit ekonomik, duke synuar respektivisht identifikimin e të gjitha të dhënave të një procedure prokurimi dhe setin e dokumenteve të operatorit ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik.

Së dyti, legjislacioni përafrohet me direktivat e Bashkimit Europian në fushën e prokurimit publik. Në linjë me direktivat e Bashkimit Europian, ndryshimet në projektligj parashikojnë mundësinë e marrjes së një ekspertize të jashtme për realizimin e procedurës së prokurimit; unifikohen procedurat e prokurimit, sipas llojeve të parashikuara në këto direktiva; rishikohen rastet përjashtimore nga zbatimi i ligjit të prokurimit publik, duke sjellë parashikime nga direktivat e Bashkimit Europian, të cilat mungojnë në ligjin aktual; parashikohet përcaktimi i kufijve monetarë, përmes një vendimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave, me vlerat përkatëse; përcaktohen katalogët elektronikë dhe sistemin dinamik të blerjes si mekanizma prokurimi që lehtësojnë procesin.

Së treti, synohet rritja e kapaciteteve administrative dhe të performancës së autoriteteve apo enteve kontraktore në procesin e prokurimit përmes riorganizimit të blerjes së përqendruar,

me mundësinë që organi qendror blerës të asistohet nga organizata ndërkombëtare me eksperiencë në fushën e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare deri në ngritjen e plotë të kapaciteteve administrative dhe profesionale.

Riorganizohen autoritetet kontraktore, përmes reduktimit të numrit të tyre, duke mos i konsideruar si të tilla ato institucione që kanë një numër të vogël punonjësish, konkretisht nën 15 punonjës, dhe që nuk kanë mundësi të ngrenë strukturat e nevojshme për zhvillimin e procedurave të prokurimit në nivelin e transparencën që ne dëshirojmë.

Së katërti, projektligji adreson problematika të dala në praktikë, gjatë zbatimit të deritanishëm të ligjit, ku ndër më kryesoret është rishikimi i dispozitave ligjore mbi konfliktin e interesave, duke parashikuar marrjen e masave në rast evidentimi të konfliktit të interesit gjatë zbatimit të kontratës. Kjo fazë ka qenë e pambuluar deri më sot në ligj.

Parashikohet si kriter shkualifikues rasti kur operatori ekonomik nuk i ka regjistruar pronarët përfitues në regjistër.

Parashikohet si kriter shkualifikues rasti kur operatori ekonomik nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni apo për punonjës të pajtuar në punë.

Rishikohet dispozita e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, për të saktësuar momentin kur dorëzohet dokumentacioni mbështetës.

Saktësohen dispozitat ligjore që lidhen me procesin e ankimit administrativ, të cilat propozohen nga KPP-ja, si institucioni më i lartë për shqyrtimin e ankesave në procedurat e prokurimit, ku përfshihet edhe sistemi elektronik i ankesave.

Parashikohen dispozita tranzitore për një periudhë 3-vjeçare, që synojnë rritjen e performancës së organit qendror blerës në prokurimin e fondeve publike, si dhe ngritjen e plotë të kapaciteteve administrative profesionale të tij, si dhe parashikohet që ky i fundit të asistohet nga UNOPS-i, si organ ndërkombëtar me eksperiencë në fushën e prokurimit.

Në fushat me interes strategjik, në drejtim të aplikimit të inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike, infrastrukturës kritike dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, Këshilli i Ministrave mund të autorizojë institucionet e administratës shtetërore apo publike në nivel qendror që të negociojnë dhe të lidhin marrëveshje konsulence ndërkombëtare brenda fushës së eksperiencës së tyre.

Ky propozim vjen me rëndësi të posaçme nga Këshilli i Ministrave, ndaj kërkojmë përvëlësisht nga deputetët që ta miratojnë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Spiropali!

Meqenëse jeni e shoqëruar edhe nga koleget...

Elisa Spiropali – Po, me zonjën Kashta dhe zonjën Kokona.

Klotilda Bushka – A kanë diçka për të shtuar, nëse duan ta marrin fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo nga prezantimi i nismëtarëve, pastaj do të kalojmë në pyetje. A ka diçka për të shtuar? Nuk ka.

Atëherë, po them unë dy-tri çështje në cilësinë e relatores dhe më pas kalojmë në pyetje e diskutime.

Pa rënë në përsëritje të atyre që tha zonja Spiropali, ky projektligj në thelb synon përafrimin me aktet e Bashkimit Europian në fushën e prokurimeve publike. Në këto dy vjet, pas miratimit të ligjit, nga praktika kanë dalë disa çështje që kanë nevojë të riadresohen në ligj, më shumë në kuadër të rritjes së transparencës dhe të forcimit të rregullave të konkurrueshmërisë, për të plotësuar standardet më të mira.

Çështja tjetër ka të bëjë me faktin e adresimit të nevojave që ka Shqipëria në kuadër të punëve që duhen kryer në disa sektorë të rëndësishëm, siç është lufta kundër korrupsionit, mbrojtja kibernetike, transparenca dhe rritja e llogaridhënies në të gjithë sektorët e administratës.

Ky projektligj ka kaluar në një proces të gjatë konsultimi. Sipas akteve që ka sjellë qeveria, shoqëruar me relacionin e projektligjit ka pasur komente nga delegacioni i Bashkimit Europian, nga SIGMA dhe nga Instituti Shqiptar i Shkencave. Një pjesë e konsiderueshme e sugjerimeve dhe komenteve janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në tekstin e projektligjit nga vetë nismëtarët. Drafti i rishikuar më pas i është nënshtruar konsultimit me aktorët publikë.

Gjithashtu, në Komisionin e Ligjeve kanë ardhur disa komente nga Instituti Shqiptar i Shkencave dhe nga përfaqësues të tjerë të organizatave të shoqërisë civile, të cilat do t'i trajtojmë gjatë pyetjeve dhe diskutimeve me nismëtarët.

Ky projektligj ka kaluar dhe është miratuar në Komisionin e Ekonomisë dhe në Komisionin e Çështjeve Europiane, ku janë paraqitur edhe disa amendamente. Amendamente të

tjera do të paraqiten edhe nga unë. Pra, në tabelën që keni marrë, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur të gjitha amendamentet që sugjerohen nga komisionet për dhënie mendimi, si dhe nga unë si relatore, të koordinuara me nismëtarët, në mënyrë që t'i jepet një efektshmëri qëllimit që kanë këto ndryshime ligjore për sa i takon kryerjes së prokurimit publik sipas standardeve të vendeve më të mira që përcaktojnë aktet e BE-së, si dhe për të rritur transparencën dhe për të garantuar që procedurat shtetërore për realizimin e fondeve shtetërore për punë mallra e shërbime të realizohen në mënyrën më efektive të mundshme.

Thënë këtë, mendoj të kalojmë te pyetjet dhe komentet. Para se t'ju kaloj fjalën për pyetje, edhe unë kam disa pyetje për nismëtarët.

Në komision ka ardhur një shkresë nga përfaqësues të shoqërisë civile, e cila ngre tri shqetësime.

Shqetësimi i parë vjen, po e lexoj siç ka ardhur në *email*, nga zonja Arianita Brahaj, drejtoreshë e organizatës “*Open Data Albania*”. Komentet lidhen me heqjen e pikës 2 të nenit 48 për sa i takon adresimit të Shqipërisë për konsulencë të shtuar për ato që konsiderohen si synime për forcimin e transparencës, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Çështja tjetër ka të bëjë me pasaportën e prokurimeve dhe çështja tjetër me kostot financiare. Kjo shkresë u është dërguar nismëtarëve.

Zonja Kashta, a mund të bëni një sqarim të këtyre çështjeve, që, me sa kuptoj, kanë qenë pjesë e diskutimeve gjatë hartimit të projektligjit dhe gjatë konsultimit publik.

Zonja Kashta, fjala për ju.

Reida Kashta – Faleminderit, zonja kryetare!

Për sa u përket tri çështjeve të ngritura nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, neni 48/2 është një nen tranzitor, i cili parashikon diskrecionin që mund të ketë Këshilli i Ministrave. Nuk është një nen në trup të ligjit, pra është i përkohshëm për një periudhë 3-vjeçare. Ai parashikon diskrecionin e Këshillit të Ministrave për dhënien e autorizimit për të negociuar një marrëveshje me konsulentë ndërkombëtarë në fusha që konsiderohen me prioritet strategjik për qeverinë, me qëllim dhënien e zgjidhjes në këto pika kyçe, siç është përdorimi i inovacionit të teknologjisë së informacionit dhe AI-së (inteligjencës artificiale), rritja e sigurisë kibernetike dhe rritja e luftës kundër korrupsionit, e shoqëruar e gjitha me transparencë. Pra, ka një qëllim të caktuar me vullnetin për ta nxitur përmirësimin në këto drejtime, që janë të mbyllura në nenin 48/2. Pra,

është një listë e mbyllur me diskrecionin e Këshillit të Ministrave, jo detyrimisht mund të ndodhë në çdo rast, që është për një periudhë 3-vjeçare si dispozitë tranzitore në ligjin e prokurimit.

Për sa i përket pasaportës së prokurimit, pasaporta është një koncept i ri që është vendosur në ligj për të krijuar një format, ku çdo autoritet kontraktor për çdo procedurë që bën, identifikohet me një pasaportë. Në diskutimet më të fundit është vendosur që nocionit të përkufizimit të pasaportës t'i shtohet edhe një listë e mbyllur e elementeve që përbëjnë pasaportën. Kjo besoj se do të dalë në diskutimet në vijim, kur të prezantoni amendimet në nenin përkatës.

Për sa u përket efekteve financiare, sikurse është sqaruar edhe në komisionet e tjera, ku është diskutuar ky projektligj, një përlllogaritje e efekteve të mundshme financiare, për aq sa del nga projektligji, janë bërë (është pjesë edhe e relacionit që shoqëron projektligjin) si në miratimin që është bërë në qeveri, ashtu edhe kur është dërguar pranë Kuvendit. Ka një projektion të efekteve financiare; ka pasur një diskutim dhe komunikim zyrtar me Ministrinë e Financave.

Nga pikëpamje ligjore, është shpjeguar procesi i ndjekjes së hapave për të marrë efektin financiar të këtij projekti që synohet të realizohet. Besoj se në këtë fazë të projektligjit, projektioni i realizon kërkesat e nevojshme, për aq sa kërkohet nga pikëpamja buxhetore. Në momentin që projektligji do të kalojë, do të bëhet një studim më i thelluar me terma të referencës nga institucionet kompetente, për të nxjerrë vlerën reale për të ndjekur hapat me Ministrinë e Financave, sipas legjislacionit në fuqi.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Kashta!

Ky është një sqarim që unë si relatore e doja tani, sepse, kur të kalojmë në shqyrtimin nën për nen, do t'i shpjegoj të gjitha amendamentet që sugjeroj, në mënyrë që të kemi një ide të qartë për atë që po flasim.

Për sa i takon shqyrtimit në parim të projektligjit (diskutimi që po bëjmë është diskutimi në parim i projektligjit), unë e vlerësoj si projektligj, sepse edhe për pjesën e përafrimit me aktet e Bashkimit Europian (sipas shënimeve përkatëse tregohet se me cilat akte ajo përafrohet), edhe në kuadër të detyrimeve të MSA-së, e ka marrë confirmimin nga Komisioni i Çështjeve Europiane.

Në fakt, këto janë dispozita që i japin vlerë rritjes së transparencës në fushën e prokurimit publik, janë dispozita që modernizojnë procedurat dhe hapin mundësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit në të gjitha këto procese. Këto parashikime ligjore i japin mundësi

Shqipërisë të jetë koherente me të gjitha sfidat që ka jo vetëm Shqipëria, por e gjithë bota për sa i takon rritjes së kapaciteteve në luftën kundër krimit kibernetik apo në rritjen e llogaridhënies nëpërmjet mekanizmit të transparencës, qoftë nga përdorimi i shërbimeve digjitale, qoftë edhe nga procedurat e kryera në mënyrë elektronike. Me pak fjalë, e vlerësoj këtë projektligj. Kur të jemi në diskutimet nen për nen, do t'i sqaroj amendamentet siç janë në tabelën e paraqitur.

Fjala është për kolegët për pyetje dhe diskutime.

Fjalën e ka zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje, kolegë!

Përshëndetje edhe të ftuarve!

Unë kam një pyetje për secilin nga përfaqësuesit e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Komisionit të Prokurimit Publik, pra për zotin Myzyri dhe zonjën Kashta.

Besoj se duhet ta kuptojmë drejt thelbin e këtij projektligji, sepse tema e prokurimeve publike është e rëndësishme dhe ka një impakt të fortë në publik. Ndaj besoj se duhet të jemi të qartë në çdo pikë dhe në çdo risi që sjell ky projektligj.

Pyetja ime për secilin nga ju është: çfarë të rejash dhe ndryshimesh sjellin ndryshimet e propozuara në ligjin “Për prokurimit publik” në punën e Komisionit të Prokurimit Publik dhe në punën e Agjencisë së Prokurimit Publik?

Pyetja e dytë është: këto ndryshime që sjell drafti që po diskutojmë sot, si lidhen me rekomandimet e progresraportit të fundit të Komisionit European? A reflektohen të gjitha rekomandimet në këto ndryshime?

Faleminderit, kryetare!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Felaj!

Në fakt, zonja Spiropali bëri një prezantim të risive të ligjit në disa drejtime, gjithsesi, për efekt të të kuptuarit të ligjit, është e rëndësishme të sqarohen në detaje. Kush e do fjalën? Zonja Spiropali?

Elisa Spiropali – Për pyetjen e parë gjykoj se zonja Kashta duhet ta marrë fjalën, se impakton drejtpërdrejt Agjencinë e Prokurimit Publik.

Klotilda Bushka – Zonja Kashta, fjala për ju.

Reida Kashta – Faleminderit!

Pyetja e parë ishte për risitë që sjell ky legjislacion në punën e APP-së dhe KPP-së. Në thelb legjislacioni synon të sjellë risi në të gjithë sistemin e prokurimit elektronik, jo vetëm në punën e APP-së, në dy drejtime kryesore.

Drejtimi i parë është ai i zhvillimeve teknologjike që u shpjeguan këtu. Pra, synon të lehtësojë të gjithë procesin e prokurimit, duke e digjitalizuar akoma më shumë, që të krijohet një ndërveprim midis palëve publike dhe palëve private në mënyrë më koherente, më transparente dhe nëpërmjet sistemeve për të minimizuar impaktin njerëzor nga pikëpamja e mundësive për abuzime me legjislacionin. Pra, synimi i ligjit është automatizimi i sa më shumë proceseve, me qëllim që të minimizojmë mundësinë për abuzime me legjislacionin. Kjo është risia kryesore e projektligjit, që synohet të arrihet në përfundim të ngritjes së një sistemi të ri të prokurimit elektronik dhe të një sistemi që ndërvepron në kohë reale me sistemet e tjera të prokurimit elektronik.

Ajo që synojmë tjetër nga ky legjislacion, është maksimizimi i burimeve njerëzore dhe profesionalizmi i procesit të prokurimit, me qëllim që të arrihet eficiencë maksimale. Këtë e bëjmë në dy apo në tri drejtime kryesore.

Së pari, synojmë të ngremë një organ qendror blerës më të fuqizuar dhe më të specializuar për të kryer procedurat e prokurimit për llogari të disa autoriteteve kontraktore, duke u fokusuar në fuqizimin e një organi të posaçëm. Ndërkohë, mundohemi të rritim kapacitetet e çdo institucioni që ka funksione të tjera, përveç atyre të prokurimit publik, dhe me këtë synojmë të rritim eficiencën.

Nga ana tjetër, sikurse u relatua, synojmë të heqim konceptin e autoritetit kontraktor në institucionet e vogla, të cilat nga pikëpamja fizike e numerike nuk arrijnë të kenë numrin e nevojshëm të stafit për të kryer një procedurë prokurimi, në këtë mënyrë mund të shkojë në moszbatim të mirë edhe nga padijenja e proceseve të prokurimit. Pra, i heqim edhe këto institucione si autoritete kontraktore, duke e orientuar zhvillimin e procedurave drejt organeve të specializuara, që mund të jenë organe eprore apo organi qendror blerës, që është lënë si mundësi. Kjo është për sa u përket dy synimeve kryesore që sjell projektligji.

Nga pikëpamja e përafrimit të direktivës apo të propozimeve dhe detyrave të lëna në progresraportin e Komisionit European, projektligji sjell disa risi të tjera. Në parim, vlen të theksohet se projektligji i prokurimit është vlerësuar si i përafruar në një masë të madhe me direktivën e Bashkimit European dhe prokurimi publik, si një ndër kapitujt kryesor, është

konsideruar si një kapitull me vlerësim mesatar dhe me progres, krahasuar me vitet e mëparshme. Sigurisht, ka ende nevojë të përafrohemi deri në fund të këtij procesi. Disa prej nevojave për përafrim janë të lidhura ngushtësisht me faktin jemi apo jo vend anëtar, ndërkohë që ne po bëjmë disa nga elementet e tjera për përafrim, për shembull, heqja e procedurës së shërbimit konsulent si e posaçme, pasi nga direktiva e BE-së dhe komentet e lëna në takimet që kemi zhvilluar me ta, duhet të konsiderohet si një procedurë e zakonshme shërbimi dhe jo një procedurë specifike. Prandaj, ky është një nga rregullimet që është vlerësuar shumë pozitiv nga komentet e dhëna nga DG GROW dhe nga Delegacioni i Komisionit European këtu.

Nga pikëpamja e progresraportit një nga elementet, për të cilat ka pasur gjithmonë një koment nga pala e BE-së janë kufijtë monetarë. Për këtë arsye, me këtë ligj nxjerrim detyrimin që Këshilli i Ministrave t'i miratojë kufijtë monetarë me një vendim të posaçëm, që do të jetë sipas atyre që parashikon direktiva e BE-së. Kështu që akti i parë, i cili do të dalë pas miratimit të këtij ligji, do të jetë miratimi i një legjislacioni dytësor për kufijtë monetarë. Kjo do të jetë një nga kërkesat kryesore që ka ardhur nga pala e BE-së. Ka disa elemente, ku ne shkojmë drejt përafrimit të mëtejshëm. Sigurisht, ka ende disa elemente të tjera, për të cilat do të jenë komentet në vijim dhe vlerësohet se do të marrim kohën graduale deri në përafrimin e plotë. Një nga ato e diskutuam edhe në Komisionin e Ekonomisë, që është nënkontraktimi, parashikimi në direktivë. Komenti i palës së BE-së është që nënkontraktimi të jetë i hapur, pra të lejohet deri në masën 100%. Vlerësojmë që në kushtet ku jemi, sigurisht për të shmangur edhe fiktivitetin e mundshëm në disa raste, nënkontraktimi nuk do të lejohet më shumë se 50%. Kjo është një nga ato pika në të cilat vendosim ende të jemi te 50%-shi. Kur të bëhemi vend anëtar, mund ta bëjmë 100%, sikurse e lejon direktiva.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Kashta!

Zonja Kokona, në lidhje me këto çështje e kërkuat fjalën?

Teknika, fjalën për zonjën Kokona.

Elira Kokona – Kryetare, kërkoj ndjesë, pata një problem në lidhjen me komisionin. Ndjesë për hyrjen me vonesë në këtë takim!

Ashtu siç e përmendi në prezantimin e saj ministrja, edhe në sqarimet që bëri kolegja Kashta, ky ndryshim i ligjit për prokurimet vjen në kuadër të prioritetëve të qeverisë për sa i përket përcaktimit, ndërhyrjes në dhënien e shërbimeve nëpërmjet përdorimit të mjeteve të teknologjisë, sa më të avancuara të jetë e mundur. Kjo është arsyeja pse ndërhyrja e ndërveprimit

me sistemet dhe krijimi i një platforme që do të bënte të mundur jo vetëm realizimin e parimit të transparencës, por edhe të eficiencës së dhënies së shërbimit, është elementi kryesor që ka diktuar nevojën për kryerjen e këtyre ndryshimeve.

Siç e përmendi zonja Kashta, ne kemi pasur parasysh në hartimin e draftligjit jo vetëm modelet e krijuara nga vendet e tjera, për aq sa është e mundur, por duhet ta theksojmë që kemi shkuar përtej këtyre modeleve duke bërë një ndërhyrje të sistemeve dhe një ndërveprim të tyre, në mënyrë të tillë që vërtet të jemi shumë krenarë për çfarë do të arrijmë në momentin që sistemi do të ndërveprojë që edhe inteligjenca artificiale të funksionojë në sistemin që kemi ideuar dhe që të krijojë eficiencën, transparencën dhe sigurimin e të gjitha parimeve të garancisë dhe të sigurisë që janë pjesë dhe thelb i veprimtarisë së autoriteteve kontraktore, por edhe të punës të Komisionit të Prokurimit dhe të Agjencisë së Prokurimit. Në këtë kontekst dy janë elementet kryesore që ndihmojnë punën e autoriteteve kontraktore, përveç elementeve specifike që kanë të bëjnë me operatorin, dosjen e tij virtuale, pasaportën specifike të punimeve që kryhen, në mënyrë që të evitohet çdo abuzimi apo keqpërdorim i operatorit në mënyrën sesi i besohet dhënia e shërbimeve drejt publikut nga njëra anë, nga ana tjetër, të gjitha veprimet që autoritetet kontraktore, njësitë e hartimit dhe njësitë e vlerësimit kanë mundësi të përdorin jo vetëm inteligjencën artificiale dhe ndërveprimin e sistemeve për të evituar çdo abuzimi, çdo keqinterpretimi të termave, sidomos të atyre me karaktere teknik.

Elementi tjetër shumë i rëndësishëm është asistenca e modeleve më të mira dhe e shembujve më të mirë që do të marrim, sidomos në 3 vjetët e parë që do të jenë të nevojshëm për ngritjen e sistemit, për vënien në eficiencë të tij dhe përdorimin e modeleve më të mira të menaxhimit si të operatorëve privatë, por edhe të atyre publikë që do të mund të ndërhyjnë, nëse është e mundur dhe e nevojshme për sigurimin e shërbimeve të prokurimit. Kjo shkon në linjë, siç e përmendi zonja Kashta, si me direktivat e BE-së, por edhe me modelet më të mira të vendeve të BE-së, të cilëve do të vazhdojmë t'u marrim në mënyrë dinamike eksperiencën jo vetëm sot nëpërmjet hartimit të këtij projektligji që ju kemi prezantuar, por edhe në vijim në modelet e punës së tyre të përditshme.

Klotilda Bushka –Faleminderit, zonja Kokona!

Zoti Myzyri, keni një përgjigje?

T'ju tregoj radhën e kërkesave të kolegëve. Zoti Myzyri në fillim për pyetjet e zonjës Felaj, më pas zonja Felaj, nëse ka pyetje të tjera, më pas fjalën e ka kërkuar zoti Ndreca. Kjo është radha. Nëse dikush nga kolegët e tjerë kërkon ta marrë fjalën, ju lutem të ma bëjë me dije.

Zoti Myzyri, fjala për ju.

Jonaid Myzyri – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Felaj!

Të nderuar anëtarë, është nder dhe përgjegjësi e veçantë për mua personalisht, por edhe për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik për të marrë pjesë në këtë mbledhje tepër të rëndësishme për diskutimin e disa ndryshimeve në ligjin “Për prokurimin publik”. Duke nisur nga 26 korriku i vitit 1995 e deri më sot, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar plot 3 ligje për prokurimin publik. Ky ligj është amenduar 14 herë dhe ne vërtet vlerësojmë se ky amendament i 15- të në tërësi i ligjit për prokurimin publik, jo vetëm që prek në thelb problemet e evidentuara gjatë viteve të fundit, por ndryshon në mënyrë rrënjësore mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë. Ndaj edhe ne jemi falënderues si ndaj qeverisë së Republikës së Shqipërisë, edhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka dëgjuar zërin e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik në disa prej propozimeve, të cilat janë evidentuar si zgjidhje të mundshme të problematikave që ne kemi konstatuar gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave si organ shqyrtues i prokurimit.

Projektligji në thelb ka si qëllim lehtësimin e të gjitha proceseve të prokurimit publik nga autoritetet kontraktore, por doja të ndaleshim në një moment tjetër: me ndryshimet e reja të ligjit “Për prokurimin publik” parashikohet zhvillimi në formë elektronike jo vetëm i procedurave të prokurimit publik, por edhe i procedurave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë së ankandeve publike dhe të koncesioneve, partneritetit publik-privat, duke e përfshirë në një sistem të vetëm zhvillimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik.

Ky projektligj synon lehtësimin e të gjitha proceseve si për autoritetet kontraktore, ashtu edhe për operatorët ekonomikë në drejtim të zhvillimit të procedurave. Gjatë viteve të fundit kam pasur nderin për të prezantuar në Komisionin e Ligeve raportin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik dhe në thelb kemi konstatuar shpeshherë përsëritje të gabimeve të njëjta nga ana e autoriteteve kontraktore dhe nga ana e operatorëve ekonomikë.

Ne vlerësojmë dhe mendojmë se me ndryshimet e reja të ligjit “Për prokurimin publik”, me vendosjen dhe forcimin e elementeve të teknologjisë së informacionit, të elementeve të

inteligjencës artificiale dhe të robotikës në sistemin e prokurimeve elektronike jo vetëm që do të ketë shmangie të përsëritjes së gabimeve 2 herë nga ana e autoriteteve kontraktore dhe e operatorëve ekonomikë, por do të ketë edhe një rritje të eficiencës, efikasitetit në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. Duke filluar nga momenti i draftimit ose nga momenti i lindjes së nevojave të parashikimit deri në momentin e realizimit të nënshkrimit dhe monitorimit të kontratës, projektligji parashikon ndërhyrje në të gjitha nenet që lidhen, duke i digjitalizuar komplet proceset, duke përkthyer në detyra digjitale çdo detyrë të parashikuar nga ligji “Për prokurimin publik”.

Një nga problematikat që Komisioni i Prokurimit Publik ka evidentuar ndër vite është mënyra e hartimit të specifikimeve teknike nga ana e autoriteteve kontraktore. Me ndryshimet e projektligjit të ri autoritetet kontraktore do të detyrohen të verifikojnë standardet kombëtare, ndërkombëtare në hartimin e specifikimeve teknike përmes ndërveprimit me sistemet e treta.

Mënyra e përlllogaritjes së fondit limit do të jetë tërësisht e ezauruar brenda sistemit të ri të prokurimeve elektronike, përfshirë edhe atë të studimit të tregut dhe të vlerësimit të ofertave.

Ne vlerësojmë tej mase vendosjen e konceptit të dosjes virtuale të kompanisë, ku operatorët ekonomikë të gjithë dokumentacionin mund ta disponojmë përmes ndërveprimit me sistemet e treta do të kenë tashmë mundësi të krijojnë dosjet e tyre virtuale në sistemet e prokurimeve elektronike dhe të marrin pjesë në garat e prokurimeve publike, duke ulur jo vetëm kostot, por duke rritur edhe shpejtësinë e procesit të vlerësimit të ofertave nga ana e autoriteteve kontraktore, pasi në elemente të caktuara në projektligj është parashikuar edhe vendosja e elementeve të inteligjencës artificiale në procesin e vlerësimit të ofertave nga ana e autoriteteve kontraktore.

Dua të theksoj efektet në sistemin e prokurimit publik, megjithëse kjo është një fazë e re për prokurimin publik, por, duke marrë shqyrtimin e rasteve të mëparshme, gjatë kësaj periudhe ne kemi evidentuar mbi 104 modele të aplikimit të inteligjencës artificiale në prokurimin publik dhe se si këto të fundit mund të përkthehen dhe të aplikohen në realitetin shqiptar.

Kemi evidentuar se në rastin e sistemit elektronik të Koresë së Jugut është shkurtuar më shumë periudha e vlerësimit të ofertave, nga 30 orë të një procedure prokurimi në 2 orë pranë autoriteteve kontraktore.

Ndërkohë në rastin e modeleve të ngjashme në Ukrainën e paraluftës vetëm me sistemet provizore të krijuara me digjitalizimin e të gjitha elementeve (jo kaq sa është ambicia në këtë

projektligj) është rritur mbi 20% eficienca e përdorimit të fondeve publike. Pra, me digjitalizimin e të gjithë hapave dhe hallkave të procesit të prokurimeve publike vlerësojmë se do të ketë një efekt rrënjësor si në sjelljen e operatorëve ekonomikë, ashtu edhe të autoriteteve kontraktore.

Ky projektligj në thelb prek edhe disa aspekte të veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht është parashikuar pezullimi automatik i procedurave të prokurimit në rast të paraqitjes së një ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Pra, në thelb nuk do të ketë më mundësinë e gabimeve procedurale njerëzore nga ana e autoriteteve kontraktore, të vijimit të hallkave të mëtejshme në një procedurë prokurimi publik në rast se ka një ankesë pranë KPP-së, por sistemi në mënyrë automatike do t'i pezullojë.

Një nga problematikat që kemi hasur gjatë viteve të fundit, sidomos me hyrjen e regjimit të ri dhe ligjit të ri “Për prokurimin publik” në fuqi, ka qenë paraqitja e ankesave para ose jashtë afatit nga ana e operatorëve publikë.

Në projektligjin e ri është parashikuar njoftimi automatik i operatorëve ekonomikë për fillimin dhe përfundimin e afateve të ankimit për çdo procedurë prokurimi.

Projektligji i ri, gjithashtu, parashikon mundësinë që jo vetëm subjektet, të cilat paraqesin ankesë, por edhe subjektet që preken nga ankesa, do të kenë mundësinë të njoftohen në mënyrë elektronike përmes një sistemi autoidentifikimi, për t'u njohur tërësisht me ankesën nga ana e subjekteve të tjera që kanë paraqitur ankesën, duke rritur në këtë mënyrë edhe transparencën në procesin e shqyrtimit të ankesave.

Klotilda Bushka – Shumë faleminderit, zoti Myzyri, për sqarimin shterues!

Zonja Felaj, keni më pyetje?

Ermonela Felaj – Meqenëse e mora fjalën, po bëj edhe 2 pyetje të tjera për t'i mbyllur pyetjet e mia dhe për t'u lënë vend kolegëve, Pyetja e parë: nëse e kuptova drejt, 3 vjet do të jetë koha e bërjes efektive të këtyre ndryshimeve?

Pyetja tjetër, në fakt, është edhe për ju relatore. Meqenëse përfaqësuesit, ata që kanë ardhur sot të prezantojnë draftligjin i njohin më mirë edhe draftin, edhe modelet ku bazohemi, për të kryer të njëjtën gjë edhe në vendin tonë, me institucionet tona, a do të ketë raste, pra sistemi a do t'i evidentojë 100% rastet e shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tenderët publikë? Kam parasysh se inteligjenca artificiale është në rregull, por nuk është mbi inteligjencën njerëzore. Thjesht dua ta di se si do të jetë kjo pjesë.

Meqenëse më tërhoqi vëmendjen zoti Myzyri me përgjigjen e tij, ndërveprimi i sistemeve do të jetë, fjala vjen ai që do të na sigurojë origjinën e financimit të projekteve? E kam fjalën që shpeshherë ne kemi diskutuar për privatë. të cilët marrin pjesë në tenderë publikë, por financimi që ata ofrojnë, nuk ka një origjinë të pastër, kështu që besoj se sistemi duhet të ofrojë mundësi ndërveprimi me sisteme të tjera që gjurmojnë origjinën e këtyre parave dhe ekzistencën ose jo të tyre për t'i përjashtuar nga prokurimi publik ofertues të tillë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Zoti Myzyri, do ta merrni fjalën ju, apo zonja Kashta në lidhje me pyetjen e parë?

Po, zoti Myzyri, më pas zonja Kashta.

Jonaid Myzyri – Faleminderit!

Projektligji i ri parashikon mundësinë e ndërlidhjes së sistemit të prokurimeve me shumë sisteme të tjera në drejtim të verifikimit të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë. Dua të theksoj se ky projektligj jo vetëm mundëson të njëjtin trajtim të barabartë midis operatorëve ekonomikë vendas, por edhe mundësinë e ndërlidhjes edhe me operatorët ekonomikë të regjistruar në një nga vendet e BE-së, duke mundësuar të njëjtin trajtim si në drejtim të dorëzimit të dokumentacionit, si për operatorët ekonomikë shqiptarë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, po ashtu edhe për operatorët ekonomikë që janë regjistruar në një nga vendet e BE-së. Sigurisht që sistemi i ri, të paktën në vlerësimin tonë, por edhe nga analiza e bërë për sisteme të tjera të ngjashme, në të cilat është mbështetur edhe analiza teknike dhe ligjore për hartimin e draftneve të projektligjit të ri, do të krijojë kushte për verifikimin e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të shmangies së gabimeve, të përkthimit në detyra digjitale të çdo detyre të parashikuar në ligjin “Për prokurimin publik”, duke minimizuar gabimet procedurale si nga autoritetet kontraktore, ashtu edhe nga operatorët ekonomikë. Nuk mund të themi që inteligjenca artificiale mund ta tejkalojë inteligjencën njerëzore, por sigurisht që inteligjenca artificiale mund t’u vijë shumë në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë në procesin e dorëzimit dhe vlerësimit të ofertave, duke rritur edhe vetë efikasitetin e sistemit në tërësi.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Zonja Kashta.

Reida Kashta – Ajo që doja të shtoja, në vijim të fjalës së zotit Myzyri, besoj se u përmend këtu, por për ta ritheksuar: një nga risitë e këtij ligji është se është shtuar si arsye

skualifikimi i operatorëve ekonomikë që nuk kanë deklaruar pronarët përfitues. Me këtë synojmë të kontrollojmë edhe burimin e financimit, ku janë të regjistruar operatorët ekonomikë dhe nëse i kanë të regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi pronarët përfitues.

Po në vijim të fjalës së zotiti Myzyri, sistemet ndihmojnë për minimizimin e mundësisë për abuzim. Patjetër që secili prej nesh do të duhet të bëjë pjesën e vet të punës, që të shkojmë në një sistem perfekt prokurimi dhe të sigurojmë barazinë e trajtimit të operatorëve ekonomikë gjatë një procedure prokurimi, pasi procesi i prokurimit fillon që në fazën e planifikimit dhe përfundon praktikisht në zbatimin e kontratës, nuk është thjesht pjesa e konkursit. Kështu që do të duhet të ndërthuren të gjitha elementet. Nga fillimi i procesit deri në përfundimin final të tij do të duhet që secili prej nesh të kryejë detyrat dhe të marrë masat, të sigurojë trajtimin e barabartë qëkur planifikohet një procedurë deri në përfundimin e zbatimit të kontratës që është lidhur në përfundim të asaj procedure.

Për sa i përket kohës së zbatimit të ngritjes së sistemit, ligji nuk parashikon një afat konkret, pasi kjo është e lidhur edhe me buxhetimin, financimin. Kemi parashikuar dhe kemi sqaruar në relacion hapat që duhet të ndiqen në koordinim me Ministrinë e Financave për të siguruar financimin sipas legjislacionit në fuqi. Pastaj duhet koha e nevojshme për zhvillimin e procesit dhe kontraktimin e subjektit që do të zhvillojë sistemin e prokurimit elektronik, zhvillimin e tij, pastaj kemi fazën e testimit. derisa ai të bëhet funksional. Nenet që lidhen me zhvillimet teknologjike, do të hyjnë në fuqi në momentin që sistemi bëhet funksional. Ky është një afat apo një moment i rregulluar nga projektligji.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Kashta!

Një sqarim edhe nga unë për pyetjet e zonjës Felaj në lidhje me ato që mendoj se u thanë, por për t'i plotësuar. Ligji parashikon kriteret të forta të integritetit në të gjitha procedurat, që në nisjen e një procedure deri në kontrollin e zbatimit të kontratës. Të gjitha këto shkojnë në përputhje me standardet që aplikohen në BE, sipas akteve të vetë BE-së.

Nga ana tjetër përdorimi i teknologjive të informacionit, shërbimeve digjitale që në momentin e fillimit deri në përfundim të zbatimit të një kontrate prokurimi, bën atë që po ndodh në të gjithë botën që ka lidhje me rritjen e transparencës dhe vënien më shumë para përgjegjësive, sepse, kur ndërlidhen të dhënat, nëse mungon një informacion, patjetër që sistemi, i cili mendohet të kryhet, pra ky sistem elektronik për ta menaxhuar në mënyrë digjitale gjithë këtë veprimtari, do të ketë po sipas standardeve të BE-së edhe standardet përkatëse të ndërlidhjes

së të dhënave, të cilat, nëse mungojnë në procesin që kryhet me letër apo në kuadrin e verifikimit po me shkresë, në këtë verifikim digjital, nëse jam e saktë në terminologji, nuk gabon, sepse ndërlidhja e sa më shumë databazave nxjerr në dritë gjithçka që ka lidhje me operatorët apo me ata që janë pjesëmarrës në garë.

Nga ana tjetër, vlen të theksohet se, kur bëhet një procedurë e tillë, sistemet që ndërlidhen me njëri-tjetrin, kanë rëndësinë e tyre të jenë të mbrojtur edhe nga sulmet. Edhe kjo është një çështje që merret në konsideratë nga ligji.

Ajo që duhet të jetë në fokus për t'u kuptuar edhe nga publiku: të gjitha çështjet që po diskutojmë këtu, lidhen edhe me një lloj ekspertize, të cilën Shqipëria nuk e ka plotësisht, ndaj në nenin 48 të projektligjit, në dispozitën kalimtare, është parashikuar të merret asistencë teknike nga UNOPS-i (organizëm ndërkombëtar me eksperiencë në fushën e prokurimit publik) që do t'i ndihmojë për një periudhë 3-vjeçare vetë autoritet përkatëse të prokurimit për ngritjen e kapaciteteve administrative profesionale. Kjo është njëra çështje që i ndihmon këto sisteme të jenë të tilla që të kapin, nëse mund t'i quajmë kështu, ato gabime që në procesin *paper base* nuk ndodhin, por në sistemin digjital janë, por edhe sesi kapacitet tona profesionale të arrijnë të lexojnë të dhënat digjitale, në mënyrë që të mos jetë vetëm intelijenca artificiale, por të jetë edhe ajo njerëzore.

Përveç afatit 3-vjeçar, që parashikohet një konsulencë nga UNOPS-i, nga ky organizëm ndërkombëtar me eksperiencë në fushën e prokurimeve publike për autoritetet tona të prokurimit publik, parashikohet edhe një periudhë 3-vjeçare, ku u lihet mundësia autoriteteve tona që të lidhin marrëveshje konsulence ndërkombëtare me ata që janë ekspertë në fushën e inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike, infrastrukturës kritike dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në mënyrë që përdorimi i të gjithë këtyre mekanizmave sot në botë, që janë të rinj (një vend është më i zhvilluar dhe një vend tjetër është më pak, por ka ekspertë, të cilët merren posaçërisht me këto çështje dhe garantojnë standard, cilësi dhe efektshmëri) të mund të realizohen brenda një periudhe 3-vjeçare. Pra, është e mbyllur, fillon me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe mbaron brenda 3 vjetësh, bie kjo pjesë e dispozitës të neni 48, me qëllim që të gjitha këto shqetësime që ngrihen në këtë debat që po bëjmë të jenë të konsultuara dhe të realizohen me ata që janë vërtet ekspertë të mirë të kësaj fushe, prandaj është vendosur termi “ndërkombëtar”, për ata që janë në avangardë në këtë drejtim.

Kështu që, çështja e integritetit të procedurave të prokurimeve në ligj adresohet me forcimin e kriterëve, me krijimin e masave të shtuara të transparencës nëpërmjet shërbimeve digjitale për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe nëpërmjet krijimit të mekanizmave të tjerë në ligj, siç është pasaporta. Pasaporta do të jetë gjendja e shëndetit të një subjekti, i cili hyn në garat e prokurimit publik, ka një jetëgjatësi, e cila herë pas here përditësohet nga këto të dhëna të sistemeve, që ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Pra, ligji jep të gjitha mundësitë që të ketë një bazë për një punë të shëndetshme në drejtim të integritetit të procedurës, të efektshmërisë dhe të përdorimit sa më mirë të fondeve publike. Mbetet për t'u parë në zbatim. Në zbatim është shumë e rëndësishme që ne të përdorin standardet më të mira dhe të kemi atë që thashë, ekspertizën më të mirë të atyre që e kanë tashmë, e kanë bërë, ku UNOPS-i është një prej tyre, por ka edhe struktura të BE-së, që mund të shërbejnë në këtë drejtim për ta ndihmuar Shqipërinë, edhe në kuadër të asistencës që ne kemi prej tyre në këtë fushë.

Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Edhe një herë, pa e zgjatur për kolegët dhe për ta mbyllur diskutimin në këtë pikë, deri në momentin e ngritjes së sistemit, të gjitha këto verifikime, që presupozohet t'i kryejë sistemi, duke ndërvepruar me baza të ndryshme të të dhënave shtetërore, për rrjedhojë edhe shkualifikime, në rast se verifikimet sjellin një përgjigje negative, a do të mund të funksionojnë nëpërmjet rrugës mekanike? Pra, të gjitha këto të reja, që projekti i sjell dhe presupozohet të bëhen nëpërmjet sistemit, derisa të ngrihet sistemi, a do të mund të funksionojnë, duke i kërkuar vetë njerëzit me anë të shkresave këto informacione, për t'u siguruar për të gjithë operatorët ekonomikë, të cilët zbatojnë kontrata të ndryshme publike?

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Felaj!

Është shumë e rëndësishme edhe kjo pyetje dhe duhet sqaruar në një përgjigje. Sot sistemi ynë i prokurimeve i ka këto garanci. Pra, me miratimin e këtij ligji në vitin 2020 të gjitha garancitë për të cilat po flasim janë, ka një progres, i cili është i pakthyeshem në këtë moment. Sigurisht, synimi i projektligjit është si ta çojmë në një standard më të lartë, që garanton një gamë shumë më të plotë të verifikimeve, në mënyrë që të evitohet çdo rast që ka rezultuar se nuk është kapur, edhe pse janë të gjitha këto garanci, pasi herë pas here nga procesi shkresor ndodh që mungojnë informacione.

Sot garancitë janë në ligj, ka një praktikë në autoritetet e prokurimit publik, si në Komisionin e Prokurimit Publik, ashtu dhe në Agjencinë e Prokurimit Publik. Po të bëjmë një

analizë, nëse marrim raportet vjetore të institucioneve dhe statistikat, rastet tregojnë se ka pasur përmirësim në këtë punë, në vijim të ndryshimeve ligjore që bëmë në vitin 2020. Çështja sot shtrohet se si të ngrihet në një nivel tjetër, duke përdorur këtë që rekomandohet më së shumti, pra teknologjinë e informacionit dhe ndërlihdjen e sistemeve për të riverifikuar dhe rikontrolluar të dhënat që vijnë edhe nga procesi shkresor. Për momentin është pjesërisht nëpërmjet sistemeve digjitale dhe pjesërisht në formë shkresore.

Për më shumë mund t'ju shpjegojë zoti Myzyri.

Jonaid Myzyri – Ju falënderoj, zonja kryetare!

Është e vërtetë që ligji “Për prokurimin publik” në fuqi i jep të gjitha garancitë procedurale për autoritetet kontraktore dhe për operatorët ekonomikë. Si nga ana e autoriteteve kontraktore, ashtu dhe nga ana e Komisionit për Prokurimin Publik, në rast të paraqitjes së ankesave, kryhet verifikim, bazuar në dokumentacion shkresor, për ato dokumentacione që nuk mund të thirren dhe të merren në ndërveprim me sistemet e treta nga sistemi i prokurimit elektronik, ose nga sistemet e treta qeveritare. Ndërkohë, në projektligjin e ri, në nenin 50, parashikohet hyrja në fuqi e dispozitave, që parashikojnë rregullimin specifik teknik për marrjen e dokumentacionit vetëm në formë elektronike dhe ndërveprimit të sistemeve për të kryer këto verifikime me ndërtimin e sistemit të ri të prokurimeve elektronike. Ndërkohë, sot nga ana e autoriteteve kontraktore, nga ana e Komisionit për Prokurimin Publik dhe nga e Agjencisë së Prokurimit Publik vijon verifikimi, bazuar në dokumentacion shkresor të të gjitha kriterëve të parashikuara në ligjin “Për prokurimin publik” nenet 76 dhe 77 dhe nenet vijuese për përputhshmërinë e kapaciteteve ligjore, teknike dhe ekonomike të operatorëve ekonomikë për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik. Por, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri dhe me ndërtimin e sistemit të ri të prokurimit elektronik, autoritetet kontraktore jo vetëm që do të kenë një përgjysmim të ndjeshëm të kohës në procesin e vlerësimit të ofertave, një përgjysmim të kohës së operatorëve ekonomikë në dorëzimin e ofertave, duke u fokusuar më shumë në aspektet teknike të ofertës së tyre, por edhe në shmangien e atyre gabimeve, që njeriu mund të mos i kapë ose mund të jetë i pakujdesshëm. Këto do të garantohen nga ndërveprimi i sistemeve dhe nga aplikimi i teknologjive jo vetëm të inteligjencës artificiale, por edhe atyre robotike, e *machine learning*, të cilat do t’u japin mundësi sistemeve që të evidentojnë risqet në zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe gabimet e operatorëve ose autoriteteve kontraktore.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Zoti Ndreca, keni fjalën, nëse nuk e do ndokush tjetër.

Plarent Ndreca – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Falënderoj edhe ministren, por edhe koleget, që kanë sjellë për miratim në Kuvend këtë projektligj, që në këndvështrimin tim është realisht një projektligj shumë i mirë, i cili bën një hap shumë cilësor përpara në rritjen e cilësisë së të gjithë procesit të prokurimit publik, jo vetëm në kuptimin e parandalimit të problematikave që mund të ketë ky proces, por edhe të sigurisë që ky proces të jetë i duhuri, transparent dhe me autoritetin e duhur.

Ajo që doja të ngrija, që, në fakt, e kam shqetësim, shkon në këtë linjë që thanë kolegët parafolës, që të gjitha këto ndryshime kanë një qëllim: parandalimin e çdolloj problematike që ndodh gjatë procesit administrativ të shqyrtimit të prokurimit publik. Pra, i gjithë fokusi është si ta bëjmë procesin administrativ të prokurimit publik sa më cilësor, sa më transparent, sa më ligjor, për rrjedhojë t'u japim një autoritet më të shtuar vendimmarrjeve në këtë aspekt.

Nga ana tjetër, konstatoj me shqetësim që në këtë ligj vijon të mbetet një parashikim, që lidhet me nenin 132 të ligjit, i cili ka të bëjë me kontrollin postfaktum dhe konstatim të kundërvajtjeve administrative postfaktum të të gjithë këtij procesi, ku kolegët me të drejtë janë angazhuar dhe kanë sjellë këtë amendim në ligj për të forcuar të gjithë procesin, i cili përmbillet me lidhjen e një kontrate, që presumohet ligjërisht për sa kohë nuk është goditur administrativisht qoftë në Komisionin për Prokurimin Publik, qoftë në Gjykatën Administrative, pra është i ligjshëm dhe prodhon pasoja të ligjshme. Ndërkohë, mbetet ai që do ta quaja “rudiment”, që të drejtën për të gjobitur postfaktum, pas lidhjes së kontratës, e ka Agjencia e Prokurimit Publik, nëpërmjet këtij instrumenti, duke e rihapur procesin, duke e rivendosur procesin në pasiguri juridike, si dhe duke vendosur në pasiguri juridike të gjithë administratorët publikë që merren me procesin.

Me këtë dua të them se kundërvajtjet administrative apo konstatimi i kundërvajtjeve administrative duhet të jenë pjesë e procesit administrativ. Pra, të gjitha instrumentet e sjella si risi në këtë ligj duhet t'u shërbejnë organeve vendimmarrëse për të verifikuar dhe vlerësuar, me qëllim riparimin e çdo problematike që konstatohet gjatë këtij procesi administrativ, duke pasur si instrument shtesë edhe vendosjen e gjobave ose konstatimin e kundërvajtjeve administrative. Ky proces duhet të jetë brenda zinxhirit administrativ të vlerësimit. Ne nuk mund të shkojmë në pikën që, pasi kemi futur të gjitha këto instrumente kontrolli, parandalimi, pas dy apo tre vjetësh

të rivefrikohet dhe rihapim procesin dhe të vendosim kundërvajtje administrative, duke i hequr autoritetin me të cilën ju më shumë se ne jeni lodhur për ta çuar në këtë pikë.

I gjithë ky proces që ju keni ndërtuar, duke futur këto instrumente shumë të mira, tenton t'i shtojë autoritetin vendimmarrës administrativ, pra që vendimmarrja është e ligjshme, korrekte, e padiskutueshme, ndërkohë që ne lëmë në projektligj nenin 132, i cili e rivë në diskutim të gjithë këtë proces.

Unë mendoj se ky nen duhet riparë, edhe në kuadër të respektimit të një parimi kushtetues, që është siguria juridike, e parashikuar në nenin 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon që normat të jenë të sigurta, korrekte dhe të qarta, subjektet dhe aktorët duhet të kenë kompetenca shumë të qarta dhe të ndara.

Mendoj se kompetenca e konstatimit të kundërvajtjeve administrative duhet të jetë në zinxhirin administrativ të vlerësimit të akteve, që mund ta këtë autoriteti kontraktor, mund ta këtë Komisioni për Prokurimin Publik të drejtën për të vendosur gjoba krahas shfuqizimit, revokimit dhe riparimit të akteve. Pra, nëse në Komisioni për Prokurimin Publik vlerëson se akti x i autoritetit kontraktor nuk është i ligjshëm, ai ka të drejtën, siç e ka edhe sot, për ta shfuqizuar, për ta revokuar, por mund t'i shtohet edhe konstatimi i kundërvajtjeve administrative, duke i dhënë të drejtën që të vendosë gjoba administrative ndaj aktorëve, të cilët janë individualizuar se kanë kryer veprimtari në kundërshtim me ligjin, madje mund të shtohet edhe fillimi i procedimit disiplinor për aktorë konkretë.

Shqetësimi i dytë që kam, që mendoj se duhet të ishte reflektuar edhe në këtë projektligj, është ndarja shumë e qartë midis kundërvajtjeve administrative dhe veprave penale. Në mos gaboj e përmendi edhe zonja Felaj, shkeljen e barazisë në tenderë. Shumica dërmuese e kolegëve këtu janë juristë dhe e dinë shumë mirë që vepra penale e shkeljes së barazisë në tenderë është një vepër *blanket*, që do të thotë se është një vepër që referon te legjislacionet administrative, konkretisht referon te ky ligj.

Nëse ne, si ligjvënës, themi që x veprim është kundërvajtje administrative, duhet të jemi shumë të qartë ky veprim nuk përbën vepër penale. Pra, ligjvënësi nuk mund të përcaktojë njëkohësisht që një fakt përbën kundërvajtje administrative dhe nga ana tjetër po ligjvënësi të thotë që i njëjti fakt mund të përbëjë edhe vepër penale.

Nëse të gjitha këto fakte që përmenden në nenin 132, por jo vetëm, përbëjnë vepër penale, nuk mund t'i përcaktojmë si kundërvajtje administrative. Nëse ligjvënësi vlerëson se akte

të tilla janë të rënda dhe nuk mjafton të përcaktohen si kundërvajtje administrative, atëherë le t'i përcaktojmë të gjitha si vepra penale dhe t'i konsiderojmë si shkelje të barazisë në tenderë, referuar dispozitës përkatëse në Kodin Penal. Nëse themi se këto veprime, sipas ligjvënësit, përbëjnë kundërvajtje administrative, sigurisht që duhen ndarë nga veprat penale, sepse mund jenë ato veprime që mund të kenë shkaktuar pasoja të rënda, mund të jenë ato veprime që mund të jenë të përsëritura ose elemente të tjera ndarëse, që ne duhet t'i bëjmë në legjislacion, për të mos krijuar konfuzione dhe për të mos e futur administratën apo administratorët e procesit të prokurimit publik në një darë, që nuk dinë nga u vjen dhe nuk dinë nga të ruhen më parë: nga Agjencia e Prokurimit Publik, nga KLSH-ja, nga SPAK-u, nga Gjykata Kushtetuese apo nga Komisioni për Prokurimin Publik.

Pra, ne duhet të jemi të qartë në hartimin e legjislacionit, në mënyrë që përgjegjësia të jetë e qartë, të jetë e rreptë, por pa krijuar konfuzion, me qëllim që të mos shkelet edhe parimi, që ne e dimë shumë mirë: *ne bis in idem*, të mos dënohen njerëzit për të njëjtin fakt dy herë apo tri herë civilisht, administrativisht dhe penalisht.

Për ta përfunduar, sepse u zgjata dhe kërkuj ndjesë, mendoj se në këtë projektligj gjërat duhet të ishin bërë të qarta, meqenëse qëllimi është ruajtja e autoritetit të organeve vendimmarrëse, duke shtuar instrumentet verifikues, kontrollues dhe instrumentet që rrisin transparencën, të ishin shoqëruar edhe me ndryshimet që ngrita si shqetësime.

Faleminderit!

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Ndreca!

Zoti Myzyri kërkon fjalën.

Në fakt, ky ishte një shqetësim, nuk ishte pyetje apo kërkesë për ndryshim, por thjesht si një çështje që u ngrit dhe meriton vëmendje.

Jonaid Myzyri – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ndreca!

Doja të theksoja që aktualisht në parashikimet e ligjit “Për prokurimin publik” Komisioni për Prokurimin Publik ka të drejtë t’u vendosë gjoba edhe titullarëve të autoriteteve kontraktore në rastet e mosbashkëpunimit me Komisionin për Prokurimin Publik. Nuk kanë qenë të rralla rastet kur Komisioni për Prokurimit Publik ka vendosur gjoba si në drejtim të mosbashkëpunimit, të mosdhënies së informacionit të duhur në kohë nga ana e titullarëve të autoriteteve kontraktore, por edhe të mosdhënies së informacionit të saktë e të plotë, sikundër

është kërkuar nga Komisioni për Prokurimin Publik në drejtim të procesit të shqyrtimit të ankesave. Është një parashikim aktual ligjor.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh që Komisioni për Prokurimin Publik (referuar të dhënave zyrtare ndër vite) shqyrton midis 10% deri në 12% të procedurave të publikuara që mund të paraqesin ankesë, ndaj edhe Komisioni për Prokurimin Publik nuk ka kompetenca të hetimit të të gjitha procedurave të prokurimit publik të realizuar, por dhe është i kufizuar vetëm në objektin e ankesës dhe për ato procedura për të cilat paraqitet ankesë.

Doja të theksoja që në legjislacion aktual ka një rregullim të tillë, të paktën për kompetencat e Komisionit për Prokurimin Publik. Ndërsa, sa u takon propozimeve të zotit Ndreca, vlerësojmë se mund të duhet një studim më i thelluar nga Komisioni për Prokurimin Publik për të paraqitur argumentet përkatëse në lidhje me sa u propozua, pavarësisht se këto nene prekin më shumë kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik sesa të Komisionit për Prokurimin Publik.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Myzyri!

Po, zonja Kokona keni fjalën.

Elira Kokona – Pavarësisht se kolegët u përgjigjën, unë doja të theksoja diçka në lidhje me shqetësimin që përmendi zonja Felaj. Në nenin 50 të projektligjit është parashikuar edhe mënyra se si hyjnë në fuqi dispozita specifike të këtij ligji. Pra, jo të gjitha dispozitat e ligjit hyjnë në fuqi në të njëjtën kohë, vetëm ato dispozita të përcaktuara në nenin 50, paragrafi i dytë, përcaktohen qartësisht se kur hyjnë në fuqi. Kjo nënkupton se deri në momentin që këto dispozita hyjnë në fuqi operatorët, autoritetet kontraktore vazhdojnë të zbatojnë rregullat e ligjit aktual, si dhe mënyrën dhe procedurat specifike të ligjit në fuqi, pa prishur dhe ndryshuar mënyrën e tyre të operimit. Vetëm në momentin kur do të hyjnë në fuqi, domethënë kur sistemi do të jetë funksional, këto rregulla procedurale të ndërveprimit së sistemeve do të mund të hyjnë në fuqi, sipas parashikimit që po diskutojmë. Ndaj, shqetësimi i zonjës Felaj është i drejtë dhe ne kemi menduar që të kemi këtë diversifikimi të hyrjes në fuqi të dispozitave të ndryshme, sidomos të atyre që kanë të bëjnë me rregullat procedurale dhe me ndërveprimet mes sistemeve.

Doja të thosha dy fjalë për shqetësimin e zotit Ndreca: qëllimi i propozuesit, më shumë se i ligjvënësit, është ai i parashikuar në relacion, prandaj shqetësimi që ngre zoti Ndreca ka nevojë për një analizë më të gjerë, më të thellë, për një vlerësim, i cili sheh mënyrën se si operon një

rregull i caktuar procedural në kontekste të ndryshme, në kontekstin administrativ, penal, civil. Në këtë kuadër, qëllimi i propozimit nuk ka qenë për të mundësuar një rregullim dhe një analizë të tillë.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Kokona!

Po, zoti Ndreca.

Plarent Ndreca – Ndoshta u keqkuptova, unë nuk thashë se shqetësimi që unë ngrita ka qenë qëllimi i propozuesit, sepse duket qartë që qëllimi i propozuesit është rritja e transparencës, rritja e cilësisë së procesit, për rrjedhojë edhe rritja e autoritetit të vendimmarrjes së administratorëve publikë, të gjithë zinxhirit administrativ, që merret me procesin e administrimit të prokurimit publik.

Unë thashë që rritja e autoritetit të këtij procesi duhet të shkojë paralelisht me moscenimin e këtij autoriteti, nëpërmjet vendosjes së dispozitave, siç është neni 132, që e rihap procesin administrativisht. Nëse ti i thua një administratori që, me të gjithë mekanizmat që unë kam vënë në dispozicion gjithë këto vite, duke e ndryshuar procedurën e prokurimit publik, duke e forcuar, duke e digjitalizuar, duke e verifikuar, duke shtuar shumë sy e të tjerë, e të tjerë, atëherë nuk mund t'i thuash administratorit publik që, prit, se pasi e lidha dhe u zbatua kontrata, hajde ta shohim edhe një herë procesin, madje edhe të të gjobisim, pra edhe të të vendosim kundërvajtje administrative.

Për të vijuar diskutimin që bëri drejtuesi i KPP-së, kjo e fundit sot, siç ju e thatë me të drejtë, ka një kompetencë që vendos gjoba për mosbashkëpunim. Këtë të drejtë e ka edhe APP-ja, sepse, në kuadër të kompetencave të saj, mosbashkëpunimi patjetër mund të konsiderohet si kundërvajtje administrative dhe ka të drejtë edhe APP-ja, edhe KPP-ja të vendosë gjobë.

Ajo që unë po them është që, për shembull, në rast se një autoritet kontraktor nuk ka respektuar kërkesat për specifikime teknike, në procesin zinxhir të ankimit administrativ, përveç konstatimit të paligjshmërisë së veprimit, shfuqizimit, revokimit dhe riparimit, patjetër që mund të ketë edhe të drejtën e gjobitjes, por kjo brenda procesit administrativ, jo jashtë tij.

Hapja, rihapja, siç ju e dini, referuar Kodit të Procedurës Administrative, është mjet i jashtëzakonshëm, nuk është mjet i zakonshëm (i zakonshëm është mjeti i ankimit) dhe mundet që APP-ja të futet në procesin administrativ duke ankimuar, duke qenë subjekt ankimues i vendimmarrjes, por nuk mund të jetë *post factum*.

Futja e një organi, kushdo qoftë ai, por në këtë rast e APP-së, *post factum*, e rihap procesin dhe i krijon pasiguri juridike të gjithë vendimmarrjes, po edhe vetë vendimmarrësve, duke i ekspozuar ata drejt proceseve që tashmë konsiderohen të mbyllura për shkak të ligjit.

Ky ishte shqetësimi që unë pata.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Ndreca!

Besoj se kjo është e qartë, siç është i qartë besoj edhe diskutimi që bëhet nga përfaqësuesit e nismëtarëve, si zoti Myzyri dhe zonja Kokona, në lidhje me mënyrën se si duhet të adresohen këto, pra ka një çështje që ka nevojë për vëmendje, dhe do të duhet të shihet në një mënyrë tërësore i gjithë kuadri aktual në fuqi, ndërkohë që ne duhet të ecim me çështjet që parashikon ky projektligj sot, pa lënë mënjanë edhe shqetësimet e tjera që ngrihen.

Tani, unë kam një pyetje të fundit, nëse nuk ka koleg tjetër që ka pyetje, për zonjën Kashta: zonja Tabaku kishte paraqitur një nismë për ndryshime në këtë projektligj, për të cilin ne ju patëm dërguar për mendime tekstet përkatëse dhe relacionet. Përgjigjja e Këshillit të Ministrave dhe juaja ka qenë që jeni duke i marrë në konsideratë ato, që ka qenë edhe arsyeja përse ne, në kuadër të parimit të kohezionit të normave, pra për të mos bërë përplasje të normave dhe për të mos pasur ndryshime kaq të shpeshta në legjislacion, sugjeruam në atë kohë që ajo nismë të shqyrtohej së bashku me projektligjin që do të vinte, që është pikërisht projektligji që kemi sot në shqyrtim.

Në lidhje me atë nismë, ju i keni marrë në konsideratë propozimet e atij drafti që kishte bërë kolegja Tabaku në atë kohë? Unë e di, sepse kam bërë një krahasim dhe shoh që i keni marrë në konsideratë disa nga propozimet, dhe e vlerësoj këtë, por do të doja ta thoshit edhe ju, në mënyrë të përmbledhur, qoftë për kolegët e komisionit, qoftë edhe për publikun.

Reida Kashta – Faleminderit, zonja kryetare!

Sikurse edhe kemi komunikuar në kohën kur propozimi i zonjës Tabaku është bërë, ne i kemi marrë në analizë që asokohe propozimet e bëra, por duke qenë se ishin në procesin e hartimit të një draftligji amendimet e ligjit ekzistues, u vlerësua edhe nga Kuvendi që këto të bashkohen dhe si të tilla, sikurse e kemi sqaruar edhe në relacion, i kemi marrë në konsideratë një pjesë të mirë të propozimeve të zonjës Tabaku, nëse mund t'i përmend këtu: koncepti i pasaportës; koncepti i detyrimit të autoriteteve kontraktore për të qenë transparente gjatë gjithë procesit të prokurimit, e shprehur në mënyrë eksplicite në një nga kompetencat e autoriteteve;

detyrimi për shkualifikim i operatorëve ekonomikë në qoftë se nuk kanë deklaruar pronarët përfitues, që vinte si propozim fillestar prej saj. Pra, janë marrë në konsideratë një sërë propozimesh, janë vlerësuar dhe ripunuar qoftë edhe në kuadër të frymës së ligjit, ndërkohë që për çdo gjë tjetër ne i kemi vendosur në relacion shpjegimet, ku disa prej tyre në vlerësimin tonë e gjenin tashmë veten e vet në ligjin ekzistues, ndërsa pjesët e tjera, sikurse unë i përmenda, u rivendosën, u saktësuan, u qartësuan dhe u vendosën në projektligjin që tashmë është në diskutim, sikurse është relatuar dhe shpjeguar në relacion për çdo nen dhe për çdo propozim jo vetëm të zonjës Tabaku, po për çdo propozim që na ka ardhur nga të gjithë aktorët.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Kashta!

Është e rëndësishme, në fakt, sepse ne duhet të tregohemi konsistentë. Ky ka qenë edhe diskutimi që ne kemi bërë në komision, por nuk kemi gjetur asokohe një dakordësi që të prisnim të integroheshin të gjitha nismat.

Gjithsesi, më vjen mirë që ju vazhdoni dhe keni mbajtur të njëjtën frymë që kishim edhe ne në komision, që ato propozime, të cilat e përmirësojnë ligjin dhe i shkojnë për shtat qëllimit të ligjit, pra për ta përmirësuar punën në këtë sektor, të parashikohen në tekstin e projektligjit që ne kemi sot në shqyrtim, pa pasur asnjë paragjykim ndaj secilit koleg në Kuvend që i ka paraqitur ato.

Mirë, kolegë, ka ndonjë diskutim tjetër?

Atëherë, bëhemi gati për votim, kolegë? U lutem kolegëve të dalin me audio.

Atëherë, ne do të vijojmë me miratimin në parim dhe më pas nen për nen, por nen për nen kemi disa tabela të paraqitura. Unë kam paraqitur në tabelë edhe sugjerimet e Komisionit për Çështjet Europiane, edhe ato të Komisionit për Ekonominë, të cilat më duken të drejta dhe do të duhet t'i bëjmë pjesë të tekstit integral të ligjit, si dhe disa amendamente të miat të rakorduara, në fakt, me nismëtarët dhe të diskutuara edhe me disa kolegë në komision, të cilët i falënderoj për kontributet në këtë nismë kaq të rëndësishme sa është ligji “Për prokurimin publik”!

Atëherë, kolegë, jemi gati për votim? Presim edhe pak çaste sa të realizojmë lidhjen me dy kolegë, të cilët kanë probleme me internetin!

Mirë, atëherë, kolegë, vijojmë. Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për prokurimin publik””? Pro? Kundër? Abstenim?

Votojmë, kolegë? Kolegët pa kamera, nëse kanë kundërshtime, të shkruajnë në komunikimin e grupit. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Neni 1 është parashikuar të plotësohet me një amendament nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, si dhe me një amendament timin, i cili, në fakt, ka të bëjë me pasaportën e prokurimit publik. Jepet një përkufizim më i qartë, nisur edhe nga komentet që vijnë nga konsultimi publik, nga organizatat e shoqërisë civile, po edhe nga sugjerime që ka bërë më parë zonja Tabaku në draftligjin që pati paraqitur. Ndërkohë, amendamentet e Komisionit për Ekonominë dhe Financat lidhen me sqarimin në ligj të asaj që sot parashikohet, që ka të bëjë me mundësinë e organizatave jofitimprurëse për të ofruar shërbime sociale nëpërmjet pjesëmarrjes në prokurimin publik, por që përkufizimi në ligj herë pas here trajtohet ndryshe nga organet kryesisht të pushtetit vendor.

Ndaj, për të evituar çdo lloj paqartësie në zbatim të këtij neni, i cili në qëllimin e tij është shumë i qartë: “Organizatave të shoqërisë civile të specializuara për shërbime sociale do të duhet të jenë, gjithashtu, pjesëmarrëse”, për ta qartësuar nga ana e teknikës legjislative, Komisioni për Ekonominë e ka dhënë këtë si sugjerim “të njëjtat organizata”, se janë një rrjet organizatash, në fakt, që, me mbështetjen e *UN Women*, e kanë kërkuar këtë si çështje për t’u adresuar qoftë në Komisionin e Ligjeve, qoftë në Komisionin për Ekonominë. Agjencia e Prokurimit Publik dhe nismëtarët janë dakord. Kështu që unë ju propozoj ta miratojmë nenin 1 me propozimin e amendamentit sipas tabelës, sipas atij teksti.

Unë, për të mos humbur kohë për ta lexuar, thjesht shpjegova thelbin e amendamentit. Kush është pro me tekstin, bashkë me amendamentin e nenit 1? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Sipas propozimit të nismëtarëve, neni 2 nuk ka asnjë ndryshim. Biem dakord? Kush është pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 3, sipas propozimit të nismëtarëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka, gjithashtu, një ndryshim...

Një sekondë, kolegë, se kam disa tabela këtu dhe më duhet të koordinoj pak!

Atëherë, neni 3 parashikon një amendament. Pas nenit 2, si fillim, do të shtojmë një nen të ri, i cili vjen, gjithashtu, si propozim i Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Neni i ri që shtohet si një nen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, pas nenit 2 të projektligjit shtohet një nen i ri i cili sugjeron që pika 1 e nenit 15 të ligjit aktual të riformulohet: “Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik operatorëve ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social dhe profesional i personave në nevojë, si personat me aftësi të kufizuar, grupet vulnerabël, sipas legjislacionit në fuqi ose të parashikojë që këto kontrata të zbatohen në tekstin e programeve për punësim, me kusht që të paktën 30% e punonjësve të këtyre operatorëve ekonomikë ose programeve të jenë punëtorë me aftësi të kufizuar ose punonjës nga grupet vulnerabël”. Pra, ky është propozimi për një shtesë pas nenit 2, që vjen po nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në vijim të amendamentit që bëmë në nenin 1, për të cilin edhe unë jam dakord, pasi e bën dispozitën më të zbatueshme.

Nismëtarët janë dakord me këtë? Zonja Kashta, nëse keni kundërshtime, mund të kërkonti fjalën.

Jeni dakord?

Reida Kashta – Po, jemi dakord me ndryshimin në nenin 15.

Klotilda Bushka – Atëherë, vijojmë me miratimin e një neni të ri pas nenit 2 të projektligjit.

Biem dakord, kolegë, sipas propozimit të Komisionit të Ekonomisë, shpjegimit që unë bëra dhe dakordësisë me nismëtarët? Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 3, për të cilin ka një amendament nga Komisioni për Çështjet Europiane, i dakordësuar me nismëtarët sipas tekstit në tabelë, i cili ka të bëjë me saktësimin e mënyrës se si komunikohet me operatorët nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Pra, sipas tekstit në tabelë, shtohet një amendament te neni i nismëtarëve me propozimin e Komisionit për Çështjet Europiane.

Biem dakord, kolegë, me amendamentin dhe me tekstin e projektligjit, së bashku me këtë amendament? Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, vazhdojmë me nenin 4, sipas propozimit të nismëtarëve. Pro?

Kolegë, votojmë, ju lutem? Kush është kundër dhe nuk është me video, të shkruajë që nuk është pro. Nëse është pro, ju lutem, me video.

Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 5, për të cilin ka një amendament që bëhet për saktësim dhe është në dakordësi me nismëtarin. Duhet bërë për qartësi norme, sepse, në fakt, parashikimi në nenin aktual thotë: “zëvendësministri ose ministri nën përgjegjësinë e të cilit është Departamenti i Administratës Publike”. Në fakt, zëvendësministri, si institucion në fushë përgjegjësie, duhet të jetë në cilësinë e ministrit, prandaj është bërë një saktësim në terminologji dhe janë lënë vetëm fjalët “ministri përgjegjës për administratën publike”, sepse neni ka të bëjë me kuadrin institucional të prokurimit publik në nenin 21 të ligjit aktual “Autoriteti ose enti kontraktor”, i cili ndryshohet me nenin 5 të projektligjit që po shqyrtojmë.

Dakord, kolegë, me këtë amendament sipas tekstit në tabelë? Pro?

Kolegë, ju lutem, votojmë! 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 6, për të cilin ka një amendament sipas tabelës, edhe ky në dakordësi me nismëtarin: “Neni 6 ndryshon nenin 21/1 “Ofruesi i shërbimit të prokurimit””, ku është bërë një saktësim për të qenë më e qartë dispozita.

Jemi dakord, sipas tekstit në tabelë të amendamentit? Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 7, sipas variantit të nismëtarit. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 8, sipas versionit të nismëtarit. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 9, sipas variantit të ardhur nga Këshilli i Ministrave, për llogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit, është neni 10 që ndryshon nenin 34, ku shtohen pikat 10 dhe 11. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Me cilin nen...? Më falni, ngatërrova nenin! Ky që sapo miratuam ishte neni 10.

Shkojmë te neni 11, sipas versionit të nismëtarit.

Votojmë, kolegë? Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12, sipas versionit të nismëtarit. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 13, sipas versionit të nismëtarit. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14, sipas versionit të nismëtarit. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 17, i cili parashikon një ndryshim në nenin 53 të ligjit në fuqi, ku flitet për blerjen e përqendruar.

Unë sugjeroj që, në dakordësi me nismëtarin, të formulohet paragrafi i parë i pikës 1 të nenit 53, me këtë përmbajtje: “Këshilli i Ministrave krijon organ qendror blerës për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore. Organi qendror blerës kryen veprimtari në zbatim të legjisllacionit në fuqi për prokurimin publik dhe çdo legjisllacioni tjetër të zbatueshëm në fuqi”. Pra, thjesht është qartësuar norma.

Bien dakord nismëtarët? Zonja Kashta, ju lutem, vetëm një konfirmim.

Reida Kashta – Dakord.

Klotilda Bushka – Biem dakord me nenin 17 dhe amendamentin e paraqitur nga unë sipas tabelës në kolonën e fundit? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Ka një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, do të shtojmë një pikë te neni 18, për teknikë legjislative, në dakordësi me nismëtarin. Kjo ka të bëjë me propozimin për rregulla të detajuara për ankandin elektronik të prokurimit, të cilat parashikohen në rregullat e prokurimit publik dhe jo në një VKM të posaçme, sikurse parashikohet edhe për sistemin dinamik të blerjes. Këtu jemi dakord bashkë me nismëtarin.

Dakord, zonja Kashta?

Reida Kashta – Dakord.

Klotilda Bushka – Atëherë, dakord me nenin 18, me amendamentin e paraqitur, gjithashtu nga unë? Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 19, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22, sipas versionit të Këshillit të Ministrave. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24, sipas versionit të Këshillit të Ministrave. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, pas nenit 25 do të shtojmë një nen të ri, sipas sugjerimit të Ministrisë së Financave, dakordësuar me nismëtarët, me këtë përmbajtje: “Procedurat e prokurimit publik me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime, një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”. Ky është sugjerim i Komisionit të Ekonomisë dhe gjykoj që është i drejtë, kështu që do të shtohet një nen i ri me këtë amendament.

Jeni dakord, kolegë? Pro? 15 pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? 15 pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? 15 pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, pas nenit 29 shtohet një nen i ri, po sipas sugjerimit të Ministrisë së Financave që, gjithashtu, lidhet me ato ndryshime që erdhën si rrjedhojë e shqetësimeve të ngritura nga organizatat e shoqërisë civile për prokurimet, unë po i quaj “sociale”. Zonja Kashta, jeni dakord për të shtuar një nen të ri?

Zonja Kashta ka fjalën. Teknika, ju lutem!

Në rregull, ndoshta ka një defekt, nuk po na ndjek, megjithatë zonja Kashta..*(nuk dëgjohet)*

Atëherë, dakord me shtimin e një neni të ri për një ndryshim në nenin 103? Pro? 15 pro.
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vijojmë me nenin 30, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim?
Nuk ka.

Miratohet.

Neni 31, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 33, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 34, sipas variantit të ardhur nga Këshilli i Ministrave. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë, para se të shkojmë te neni 35 do të shtojmë një nen të ri, që është sugjeruar nga Komisioni i Prokurimit Publik, dakordësuar me Agjencinë e Prokurimit Publik, sa i takon paraqitjes së argumenteve në sistemin e ankesave elektronike. Bëhet fjalë për të gjithë procesin e ankimit elektronik, që tashmë bëhet në formë elektronike, ku duhet parashikuar edhe kjo hallkë e paraqitjes së argumenteve të palëve.

A jeni dakord me këtë sugjerim? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me neni 35, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 36, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 37. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 38, sipas versionit të paraqitur nga nismëtarët. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 39, sipas versionit të nismëtarëve. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 40, sipas versionit të ardhur nga Këshilli i Ministrave. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 41, sipas projektligjit. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 42. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 43. Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Neni 44, sipas versionit të projektligjit ardhur nga Këshilli i Ministrave. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 45, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 46, sipas versionit të projektligjit. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 47, sipas variantit të ardhur nga Këshilli i Ministrave. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Te neni 48, unë kam bërë një amendament për saktësi dhe qartësi norme në dakordësi me nismëtarin, bëhet fjalë për pikën 2 të nenit 48, ku thuhet: “Brenda një periudhe 3-vjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave mund të autorizojë institucionet e administratës shtetërore ose publike, në nivel qendror, të negociojnë drejtpërdrejt dhe të lidhin marrëveshje konsulence (bëhet fjalë për marrëveshje konsulence) me subjekte ndërkombëtare brenda fushës së tyre në fusha me interes strategjik, në drejtim të aplikimit të inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike, infrastrukturës kritike dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në dakordësi me nismëtarin, gjithashtu, pas pikës 3 të nenit 48 do të shtohet një pikë 4 me këtë përmbajtje: “Procedimet administrative të nisura nga Agjencia e Prokurimit Publik për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike, sipas nenit 78, pika 1, germa “b”, të cilat janë në proces, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vijojnë, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi, në momentin e nisjes së tyre”. Kjo është për të rregulluar periudhën tranzitore të projektligjit.

Jeni dakord me nenin 48, me amendamentet e paraqitura sipas tabelës? Pro? 15 pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 49, sipas versionit të projektligjit. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 50, sipas versionit të ardhur nga Këshilli i Ministrave. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në rregull, mbaruam me shqyrtimin nen për nen. Ndërkohë do të kalojmë te votimi në tërësi.

Kolegë, a jemi dakord me projektligjin në tërësi, së bashku me amendamentet e kryera? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë, me këtë miratim kemi bërë gati edhe këtë projektligj. Biem dakord të gjithë si komision që duhet të punohet me draftin integral dhe të gjitha ndryshimet që u bënë të shkojnë në seancë plenare në draftin integral. Edhe një herë, nismëtarët dhe këshilltarët e komisionit, së bashku me shërbimin e redaktimit këtu në Kuvend, të bëjnë gati versionin nismëtar dhe të përfundojnë tekstin integral që do t'i kalojë seancës plenare për votim. Pra, të kalojë me tekst integral, që të mos ketë vështirësi në procesin e votimit në seancë plenare, sipas parashikimeve të Rregullores. Edhe komentet tona për sqarimet e shqetësimeve që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile apo të tjera, në kuadër të konsultimit publik, kryer nga vetë nismëtari, por edhe nga Kuvendi, të jenë pjesë e sqarimeve në raportin e projektligjit, i cili është një dokument parlamentar dhe do të shërbejë, që të mos ketë asnjë keqkuptim në zbatimin e ligjit.

Kolegë, ju falënderoj!

Falënderoj zonjën Spiropali dhe përfaqësuesit e nismëtarit!

Ju kërkoi ndjesë, sepse do të duhet ta ndërpresim mbledhjen! Do të bëjmë pak pushim për të vijuar më pas me pikën e fundit të rendit të ditës.

Zoti Rusmajli dhe kolegë nga Presidenca, kërkoi mirëkuptim tuaj. Do të bëjmë vetëm disa minuta pushim dhe do të rinisim mbledhjen për pikën e fundit të rendit të ditës, që ka të bëjë me dekretin e Presidentit.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.2.2024, ora 10:00

Drejton mbledhjen (online):

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Dekreti nr.10, datë 13.1.2023 “Për kthimin e ligjit nr. 93/2022 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë””.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Jurgys Çyrbja, Toni Gogu, Damian Gjikhuri, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Eduard Ndreca, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaça, Plarent Ndreca, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Arkend Balla, Gledis Çeliku, Ermonela Felaj, Gerta Duraku, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Dhurata Çupi, Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Klevis Xhoxhi, Enkelejd Alibeaj dhe Dashnor Sula.

Mungojnë:

Bledion Nallbati, Gazmend Bardhi, Elda Hoti, Fatmir Mediu, Greta Bardeli, Oerd Bylykbashi, Erisa Xhixho dhe Saimir Korreshi.

Të ftuar:

Valbona Lusha - sekretare e Përgjithshme në Presidencë

Ilirjan Rusmajli - këshilltar i Presidentit

Erjola Shia - drejtore e Shërbimeve Juridike në Presidencë

Elira Kokona - këshilltare e Jashtme pranë Kryeministrit

Klotilda Bushka – Kolegë, bëhemi gati për rifillimin e mbledhjes.

Teknika vetëm të më konfirmojë që jemi *live* edhe në rrjetet sociale, edhe në faqen e Kuvendit, për efekt të rregullave në Rregullore mbledhja jonë duhet të jetë në transmetim *live*. Edhe kolegët e tjerë, kush të mundet, të bëjë lidhjen audio-video.

Atëherë, kolegë e ndërpreme mbledhjen për pak pushim dhe jemi te pika e fundit e rendit të ditës, dekreti nr.10, datë 13.1.2023 “Për kthimin e ligjit nr. 93/2022 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë””. Ne kemi ftuar, nga Presidenca, zonjën Valbona Lusha, sekretare e Përgjithshme, zotin Ilirjan Rusmajli, këshilltar i Presidentit dhe zonjën Erjola Shia, drejtore e Shërbimeve Juridike, të cilët janë *online* në të njëjtin vend.

Mirë se erdhët zonja Lusha, zonja Shia dhe zoti Rusmajli!

Ndërkohë, nga nismëtarët, për ligjin e kthyer me dekretin e Presidentit nr. 10, datë 13.1.2023, është e ftuar zonja Elira Kokona.

Për të informuar kolegët, ne kemi bërë disa takime në lidhje me këtë dekret për të koordinuar dhe për të gjetur një zgjidhje, sepse, parimisht, ne biem dakord që dekreti do të pranohet pjesërisht. Gjithsesi, për sqarime të mëtejshme, unë do t’u jap fjalën përfaqësuesve të Presidencës në lidhje me qëndrimin e tyre sa i takon dekretit dhe më pas do ta marrë fjalën, nga zyra e Këshilli të Ministrave, zonja Elira Kokona.

Zoti Rusmajli, zonja Lusha ose zonja Shia, kushdo nga ju që do ta marrë fjalën në emër të Presidencës, është i lirë të flasë tani.

Teknika, fjalën te zyra e Presidencës.

Valbona Lusha - Përshëndetje!

Ju falënderojmë për bashkëpunimin, për gjithë këtë pjesë në lidhje me ligjin për dekoratat!

Për komente po ia kaloj fjalën zotit Rusmajli.

Ilirjan Rusmajli – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderimi shkon në mënyrë të veçantë për ju, për përpjekjet që keni bërë për t’i dhënë mundësi grupit negociator për të gjetur një zgjidhje kompromis, lidhur me arsyet për të cilat Presidenti i Republikës kërkoi rishqyrtimin e ligjit në fjalë.

Ne jemi njohur me materialin përfundimtar të përgatitur nga stafi juaj lidhur me propozimet që janë pranuar nga ana e komisionit dhe ato që janë refuzuar. Sigurisht, nuk e

quajmë dot rezultatin më të mirë të mundshëm për këtë negociatë. Nuk mund të themi se negociata ka arritur suksesin, sepse propozimet që ne ju kishim bërë ishin propozime që realisht hiqnin të gjitha dilemat që mund të kishim lidhur me kushtetutshmërinë e aktit. Në version të reduktuar, nuk është e sigurt nëse ato i heqin më këto dilema. Gjithsesi, pa u ndalur tek teksti konkret i propozimeve, me lejen tuaj, dua të theksoj një çështje që mendoj se është e rëndësishme.

Së pari, duhet të jetë e qartë për të gjithë, Presidenti i Republikës nuk është i etur të japë dekorata. Nuk është çështje e tij personale. Nuk është makth për të dhënë sa më shumë dekorata. Nuk është ky modeli i tij. Nga ana tjetër, Presidenti i Republikës është i vetëdijshëm që dhënia e dekoratave, në vetvete, është një shenjë e rëndësishme nderimi që shteti shqiptar rezervon për bijat dhe bijtë e tij më të çmuar, sikurse e rezervon për miqtë më të mirë, prandaj, për këtë shkak është një çështje që meriton seriozitet.

Së dyti, kompetenca, prerogativa e kryetarit të shtetit për të dhënë dekorata është një prerogativë e rëndësishme e tij dhe, si e tillë, duhet t'i qëndrojë çdolloj sfide sa i takon kushtetutshmërisë. Për këtë arsye, u bë lëvizja nga ana e institucionit, për të gjetur gjuhën e përbashkët, për të davaritur ato dilema që ne kishim lidhur me kushtetutshmërinë e aktit, prandaj ne bëmë përpjekjen tonë maksimale për të arritur në një konkluzion të pëlqyeshëm.

Ne mund të kuptojmë fare mirë se jo çdo negociatë që zhvillohet për kompromis mund të ketë rezultat pozitiv. Nuk është e thënë të ndodhë kështu dhe nuk është domosdoshmërisht kështu. Kjo nuk është detyra e politikës. Detyra e politikës është të përpiqet të gjejë zgjidhje, dhe ne e kuptojmë këtë fakt. Ndoshta, ne nuk kemi qenë të zotët të argumentojmë aq sa duhet arsyet dhe motivet tona përpara ekipit negociues të komisionit tuaj. Ndoshta, kufijtë, barrierat kanë qenë të patundshme dhe ne nuk kishim forcën t'i lëkundnim ato.

Gjithsesi, ne ju falënderojmë për përpjekjen që keni bërë, e çmojmë shumë dhe e konsiderojmë si akt serioz nga ana e kryetares dhe komisionit, sepse kryetarja është përfaqësuesja e komisionit, edhe e negociatorëve të tjerë. Gjithsesi, duhet të themi dhe të pranojmë që ne duhet të ruajmë me doemos rezervën për të parë produktin përfundimtar që do të dalë nga dora juaj dhe nga dora e Parlamentit, për ta konfrontuar atë me konceptin tonë për kushtetutshmërinë e ligjit. Pastaj, është vullneti sovran i Presidentit që do të vendosë nëse do t'i shfrytëzojë mjetet kushtetuese, në qoftë se do të krijojë bindjen që ka vend për t'i shfrytëzuar ato, apo do t'i japë mundësinë ligjit që të futet në provë. Gjithsesi, mjetet kushtetues aty janë, ai dhe

presidentë të tjerë pas tij mund t'i shfrytëzojnë, sepse në Gjykatën Kushtetuese nuk ka afat për të bërë një *challenge* për kushtetutshmërinë e një ligji. Kështu, unë nuk dua të bëj komente të tjera, veç t'ju falënderoj për seriozitetin me të cilin e trajtuat gjithë këtë procedurë dhe gjithë këtë negociatë.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Rusmajli!

Ky është një proces që Kuvendi e ndjek pothuajse në të gjitha çështjet ku institucione të caktuara, aq më tepër institucioni i Presidentit, pa diskutim, ka rolin e tij dhe duhet të jetë pjesë e punës, jo thjesht një aktor i jashtëm. Kështu që, edhe unë e vlerësoj faktin që ju e keni vlerësuar procesin që bëri Komisioni i Ligjeve.

Falënderoj të gjithë kolegët deputetë, në fakt, që kanë pasur këtë qasje në kuadër të trajtimit të këtij akti!

Besoj se kemi arritur, të paktën për sa na takon, të ruajmë ato çështje që lidhen me garantitë kushtetuese, pra për ta zbatuar në përpikmëri. Pa diskutim, nuk mund të biem dakord për të gjitha gjërat, por ne kemi pasur një proces të hapur diskutimi të trajtimit të secilës çështje. Unë mendoj se kemi arritur në një vendim që është edhe politik, për ta pranuar dekretin me disa amendamente në ligjin e miratuar, të cilat do t'ua paraqes kolegëve kur të kalojmë te votimi i tyre.

Gjithsesi, dua t'ia jap fjalën zonjës Kokona, si përfaqësuese e zyrës së Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave, në lidhje me këtë çështje, përpara se të kalojmë te propozimet e posaçme dhe te votimi i dekretit.

Zonja Kokona, fjala për ju!

Faleminderit që keni harxhuar të gjithë ditën me ne sot, me kontributin tuaj, të cilin e çmojmë!

Elira Kokona - Është kënaqësi, kryetare, sidomos të jem pjesë e punëve të Komisionit të Ligjeve edhe për shkak të afërsisë me eksperiencat, edhe prej profesionit.

Gjithashtu, është kënaqësi të jem pjesë në këto takime, sepse të gjitha debatet që krijohen janë të vlefshme, ashtu siç ka qenë mjaftueshëm i vlefshëm dhe me shumë rëndësi roli që ne i kemi dhënë diskutimit me kolegët e Presidencës në negociim, siç me të drejtë e përmendi zoti Rusmali, së bashku me ju dhe nën drejtimin tuaj. Ne jemi ulur dhe kemi bërë një seri seancash konsultuese si në parametrat kushtetues, ashtu edhe në ata proceduralë, në mënyrë që të kemi jo vetëm një akt të vlefshëm në mënyrën e tij të funksionimit, që të respektojë kornizën kushtetuese

dhe ligjore të Republikës së Shqipërisë, por të jetë edhe një akt që krijon eficiencë në mënyrën e tij të operimit, deri në zbatimin e tij.

Unë dua të përmend vetëm diçka që mendoj se është e rëndësime: qëllimi pse Këshilli i Ministrave doli me këtë nismë, e ndërmoi dhe e realizoi këtë nismë, ishte për dy arsye madhore. Arsyeya e parë, që të ishim në të njëjtën linjë me kuadrin ligjor që rregullon kompetencat e Presidentit të parashikuara në nenin 92 të Kushtetutës, i cili nuk është vetëm në rastin e dhënies së dekoratave dhe të titujve të nderit, por edhe në rastin e shtetësisë, edhe në rastin e gradave të larta ushtarake, që i jep mundësinë Presidentit të Republikës të japë dekorata, sipas parashikimeve të ligjit specifik. Kjo ishte arsyeja, prandaj ne u munduam të ndjekim të njëjtin ligj, të njëjtin kuadër dhe logjikë, të përdorur në ligjin mbi shtetësinë, që është ligj i vitit 2020, pra, le të themi, është një ligj modern, që ka pasur parasysh një seri ndërhyrjesh nga kolegët, edhe me marrjen e modeleve të vendeve të tjera. Pra, logjika kushtetuese ishte për ndjekur të njëjtën frymë, ku Presidenti i Republikës dhe institucioni që ai drejton janë patjetër pjesë e procesit, por nuk janë vendimmarrësit thelbësorë. Patjetër, janë pjesë e procesit të akordimit dhe të dhënies të dekoratave dhe titujve, ashtu si në rastin e shtetësisë, ku Presidenti është dhënës i shtetësisë, por nuk është entiteti që mbart rregullin procedural, kryen procedurën e verifikimeve, apo të gjitha detyrat me karakter administrativ. Për këtë arsye, si në atë rast, edhe në këtë rast, ka një organ kolegjal në të cilin Presidenti e ka të përcaktuar anëtarin e tij, ku vendimet merren në mënyrë kolegjiale dhe këto vendime nuk janë me karakter vendimmarrës, por jepet mendim. Pra, në organin kolegjal, në ndryshim nga rasti i shtetësisë, vendimet janë me natyrë mendimdhënieje, pra, le themi, me natyrë këshilluese. Pra, janë mendime për sa u përket kompetencave, specifikave dhe eksperiencave që kanë anëtarët e këtij komisioni dhe mbartin këtë rol në mendimin që jep ky komision.

Është e rëndësishme dhe dua ta theksoj se është shumë e vërtetë ajo që tha kryetarja, dhe më bëhet qejfi që e përmendi edhe Rusmajli, eksperti. Ne mendojmë se draftin që kemi sjellë është një draft më i mirë se ç'ishte, sepse krijon ca ekuilibra të reja dhe patjetër që dëgjon edhe shqetësimet, si shqetësime të karakterit të eficiencës, por edhe shqetësime të bashkërendimit të punës dhe të koordinimit midis institucioneve, për të dhënë një gjë kaq simbolike, e cila i referohet pikërisht meritës, reciprocitetit, akordimit të një merite, të një titulli a dekorate të caktuar, që duhet të mbahet me nder, si një simbol i respektit institucional të shtetit në tërësi, drejt individit që e merr këtë titull a dekoratë. Nuk duhet të jetë shkak ose mbartës i debateve e i

diskutimeve midis institucioneve në lidhje me dobishmërinë a ligjshmërinë e akordimit të kësaj dekorate apo të këtij titulli.

Për këtë arsye, unë i falënderoj kolegët e presidencës, pavarësisht se e kuptoj që mbase nuk arritëm në një version të miratuar totalisht prej tyre, sikundër nuk është as në versionin e propozuar nga Këshilli i Ministrave. Jemi këtu pikërisht për të ardhur në mes, për të ardhur në një version, i cili është i vijueshëm, i pranueshëm dhe që siguron ato çfarë unë përmenda më sipër: kuadrin kushtetues dhe kuadrin ligjor procedural të kornizës ligjore në përgjithësi, për të mos krijuar ishuj në mënyrën se si procedohet me ligje që janë pikërisht në zbatim edhe të kompetencave të Presidentit, të parashikuara në nenin 92 të Kushtetutës.

Kësisoj, unë nuk kam komente të tjera, kryetare, por mbetem e hapur për çdo lloj diskutimi, pyetje apo sqarimi nga ana juaj apo nga ana e anëtarëve të këtij komisioni.

Klotilda Bushka – Shumë faleminderit, zonja Kokona!

Atëherë, mund të bëjmë një panoramë të ndryshimeve.

Kolegë, ka një tabelë me katër kolona ligji, siç është miratuar herën e parë. Në kolonën e dytë janë propozime që vijnë nga Zyra e Presidencës, në kolonën e tretë ka një lloj dakordësie të diskutimeve, ndërsa në kolonën e fundit është versioni përfundimtar i amendamenteve në nenet që unë propozoj, të cilat janë dakordësuar tashmë në pjesën më të madhe të tyre.

Synimi i gjithë këtij diskutimi, së pari është të ruajë diskrecionin dhe të drejtën e Presidentit sipas Kushtetutës, në nenin 92, në lidhje me dekoratat që duhen dhënë sipas përcaktimeve në ligj. Qëllimi i ligjit, siç është diskutuar më parë dhe siç biem të gjithë dakord, ka të bëjë me disiplinimin e procedurave standarde të njëllojta, që zbatohen kur nderohen personalitete të rëndësishme shqiptare apo të huaja. Në këtë aspekt igji parashikon disa filtra e autoritete përkatëse, para se të shkohet në një vendimmarrje finale. Sigurisht, në këtë ligj nuk janë të rregulluara vetëm kompetencat e Presidentit, por është një gamë e gjerë. Por s’dua të bëj një diskutim sipas shqyrtimit në parim të projektligjit, sepse ne e kemi diskutuar më parë, por thelbi i ndryshimeve ka të bëjë me heqjen e të gjitha dyshimeve, të cilat mund të krijojnë perceptimin e ngushtimit të kompetencës së Presidentit, parashikuar në Kushtetutë me ligj. Pra, kjo shmanget, bëhet më e qartë. Së dyti, bëhet për t’i dhënë jetë e për të mos pasur keqkuptime, kur ligji zbatohet në praktikë, në lidhje me atë që do të duhet të jetë fokusi i ndërveprimit institucional.

Thënë këtë, ne patëm një diskutim shumë të mirë, shumë të sinqertë e shumë profesional me të gjitha grupet negociuese, edhe të Presidencës, edhe të nismëtarëve, por edhe të ekspertëve përkatës në Kuvend, dhe kemi arritur në një lloj dakordësie. Sigurisht, të gjitha palët mund të kenë ende “pakënaqësi”, nëse mund ta them, por e rëndësishme është që në një draft të miratuar në Kuvend dhe në disa propozime të dekretit, ne kemi gjetur tashmë dakordësi për një pjesë të rëndësishme, që garantojnë pikërisht mundësinë që institucioni i Presidentit t’i ushtrojë brenda tagrave kushtetuese kompetencat e veta, si dhe të rritet në praktikë efektiviteti i asaj që kërkon edhe jurisprudenca: ndërveprimi institucional, bashkëpunimi institucional dhe krijimi në ligj i disa *checks and balances*, të cilat i plotësojnë këto synime.

Nëse i marrim me radhë, sipas tabelës, ndryshimet bëhen në nenin 4, ku shtohet një fjali. Parashikohet që personat, të cilët do të jenë anëtarë të urdhrave nuk duhet të kenë qenë bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit, gjë për të cilën jemi dakord. Unë nuk e di për procedurën, nëse do t’i kalojmë nen për nen.

Zonja Felaj, nëse më ndihmoni, proceduralisht do t’i kalojmë të gjitha ndryshimet, t’i votojmë nen për nen, apo duhet të bëjmë më parë votimin në parim të pranimit të dekretit pjesërisht, sipas amendamenteve? Në fakt, sipas praktikës, kemi kaluar me votimin në parim të pranimit të dekretit pjesërisht, e më pas kemi kaluar në votimin e neneve që amendohen.

Do të doja një mendim nga ju, zonja Felaj: a biem dakord të vijojmë kështu?

Ermonela Felaj – Po, më duket logjike të vijojmë në këtë mënyrë. Ju e thatë që në krye të herës, që dekretin e pranojmë vetëm pjesërisht, pasi duam të propozojmë disa riformulime nenesh, kështu që votohen edhe nenet e reja që riformulohen, e ky është pastaj raporti që i çohet Parlamentit.

Klotilda Bushka – Kjo vjen edhe konform nenit 86 të Rregullores.

Faleminderit, zonja Felaj!

Mirë. Atëherë, kolegë, bëhemi gati të kalojmë në votimin në parim të pranimit të dekretit pjesërisht, sipas amendamenteve që kalojnë pastaj në votim.

Jemi dakord, kolegë?

Ju lutem, kush mundet, të hapë kamerat. Kush nuk mundet, le të shkruajë në grup.

Në rregull!

15 pro. Në grup nuk ka kundërshtime.

Miratohet në parim pranimi i dekretit pjesërisht, sipas ndryshimeve që do të paraqesim në vijim.

Atëherë, në nenin 4, siç jua shpjegova, bëhet fjalë për vënien e një parashikimi në ligj, sipas të cilit anëtarët e urdhrave nuk mund të jenë persona që kanë qenë bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit.

A jemi dakord? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në nenin 7 të projektligjit do të bëjmë një ndryshim tjetër për efekt saktësimi, për shkak të funksionit: “Presidenti i Republikës, për shkak të funksionit është mbajtës i shkallës “Ylli i Madh” që nga dita e marrjes së detyrës ”. Do t’i heqim fjalët “për shkak të funksionit”, sepse kjo është një e drejtë që e merr dhe e fiton, kështu që kemi rënë dakord. Ju e keni tabelën, ndaj nuk po i lexoj të gjitha dhe po kalojmë në procesin e votimit.

A jemi dakord me amendamentin e nenit 7?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Sekretarisë i lutem të ndjekë pak votimin dhe kuorumin.

Në rregull. Miratohet!

Në nenin 8 ka një amendament, kështu që do të ketë një ndryshim. Pra, edhe në nenin 8 do të rakordohet i njëjti ndryshim që bëmë në nenin 7. Ndërsa në fjalinë e dytë të pikës 4, për teknikë legislative kjo nuk do të jetë si amendament. Do të jetë vetëm pjesa e parë e fjalisë.

Dakord me këtë amendament?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në nenin 18, sipas tabelës, një amendament i rakorduar. Në nenin 18, pika 2 të ligjit, pas fjalës “kriteret” do të shtohet edhe fjala “procedurat”.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në nenin 21 ka një amendament tjetër të rakorduar sipas propozimit të Presidencës. Dakord? Bëhet fjalë për togfjalëshin “shtetas të huaj”, që do të zëvendësohet me togfjalëshin “personalitete të huaja”, si dhe disa rakordime të tjera, për të cilat është rënë dakord. Nenin 21, pika 2, i cili flet për dekorimin e personaliteteve të huaja: “Për shkak të funksionit t’i njoftohet

kancelarisë jo më vonë se 30 ditë nga data e dhënies së dekoratës, me qëllim regjistrimin në regjistrin e personave të dekoruar, duke u hequr detyrimi për të marrë një mendim nga kancelaria.”

Kjo është një e drejtë absolute e Presidentit.

Dakord me këtë amendament në nenin 21?

Pro? 15 pro. Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet.

Neni 22. Edhe këtu ka një amendament, që lidhet me saktësime në nenin 22, që flet për numrin vjetor të dekorimeve.

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet.

Mund të më ndiqni me tabelën, kolegë!

Në nenin 24 nuk ka amendamente. Në nenin 25 do të kemi një amendament. Në nenin 25 do të shtohet një pikë 5 “Çdo detyrë e ngarkuar nga kolegji” dhe do të rakordohet unifikimi i termave.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet ky amendament.

Në nenin 26 janë disa detaje teknike për kancelarinë e urdhrave të medaljeve, që do të ketë logon, stemën dhe shenjat dalluese, që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, kjo shtohet në amendamentin e nenit 26.

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet.

Vijojmë me nenin 28, me pikën 1, sipas tabelës. Kjo është për qartësi. Do të hiqet shkronja “a”: “i cili ka të bëjë me një kriter moshe”. Flitet për anëtarët e Kolegjit të Urdhrave e Medaljeve. Një nga kriteret ka qenë kur mbush moshën, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për personalitete, që kanë katër vjet mandat. Është vlerësuar që kriteri i moshës të hiqet fare.

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet.

Neni 29. Amendamenti për detyrat e Kolegjit të Urdhrave e Medaljeve, sipas kolonës së fundit.

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet.

Neni 30. Neni i kancelarit. Edhe këtu do të bëjmë disa ndryshime sipas tabelës.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet.

Në nenin 31 nuk kemi amendament.

Në nenin 32, që lidhet me dekorimet kryesisht, do të kemi disa ndryshime të rakorduara.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet.

Në nenin 33 nuk kemi amendament.

Në nenin 34 kemi një amendament.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Unë po i them pak ngadalë, që nëse ndonjë nga kolegët ka ndonjë çështje për diskutim, t'i japim mundësinë të marrë fjalën.

Neni 35. Në kreun IV janë pranuar propozimet e Presidencës, që unë si relatore sugjeroj: “Vlerësimet e Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve. Pas shqyrtimit të dosjes së propozimit për dekorim, Kolegji i Urdhrave dhe Medaljeve jep mendim të arsyetuar”. Fjala “vendim” ndryshohet dhe bëhet “mendim”, për të përputhur plotësisht të drejtën diskrecionale që ka Presidenti në lidhje me këtë çështje, miratimin e propozimit ose refuzimin e propozimit. Në çdo rast, mendimi i arsyetuar i Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve në lidhje me propozimin i njoftohet autoritetit përgjegjës për dhënien e dekoratës dhe autoritetit propozues. Presidenti vendos për dhënien ose mosdhënien e dekoratës, pavarësisht vlerësimit përkatës të kolegjit.

Siç e thashë, qëllimi i kësaj dispozite është që në këto raste të përputhet tërësisht me Kushtetutën kompetenca diskrecionale e Presidentit. Synimi i dispozitës ka të bëjë me rastin kur autoriteti vendos të mos e japë një dekoratë. Këtu qëndron thelbi. Presidenti mund të ketë edhe një mendim ndryshe. Në rastet kur e jep, do të duhet që kompetenca e Presidentit, në kuadrin e ushtrimit diskrecional të tij, të jetë ajo e përputhshmërisë së vendimmarrjes.

Gjithsesi, ky është amendamenti. Siç e thashë, thelbi konsiston në përputhshmërinë e plotë, për të mos krijuar asnjë ekuivok në zbatimin e të drejtave kushtetuese.

Kolegë, a jemi dakord me këtë amendament?

Pro? 15. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet.

Neni 36. “Ceremonia e dekorimit”.

Këto janë detaje të organizimit të ceremonive, si dhe të teknikës legjislative. Më shumë është qartësuar norma.

Dakord, sipas kolonës së fundit të nenit 36?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Gjithashtu, në tabelë nuk keni një formulim tjetër. Në pikën 6, te neni 38 do të hiqen në fund fjalët “ose nga një autoritet tjetër shtetëror, i lartë, deleguar shprehimisht”.

Në pikën 7 do të kemi një ndryshim të përmbajtjes: “Dorëzimi i dekoratave të shkallëve tjera të urdhrave dhe medaljeve, bëhet personalisht nga Presidenti i Republikës, nga përfaqësuesi i tij ose nga një autoritet tjetër i deleguar prej tij. Në ceremoninë e dekorimit marrin pjesë edhe përfaqësues të institucionit propozues”. Për teknikë legjislative neni është riformuluar në dakordësi me nismëtarët, por edhe me Presidencën.

Dakord me propozimin sipas kolonës së fundit në lidhje me nenin 36, por edhe të këtyre që lexova unë? Në zbardhje duhet të jenë fakte.

Dakord.

Miratohet neni 36!

Neni 37 nuk ka amendament.

Neni 38. “Aktet nënligjore”. Do të duhet të saktësohen edhe një herë se cilat janë aktet nënligjore, që nxirren në zbatim të këtij ligji, sa kohë që kemi bërë disa rregullime në nene, për t’i parë edhe një herë. Nuk e besoj se ka, por kjo është një detyrë e teknikës legjislative. Këtu nuk kemi amendament, por kjo thjesht do të jetë pjesë e redaktimit.

Neni 40 nuk ka.

Ndërkohë, për hyrjen në fuqi, pas bisedimeve me zyrën e Shërbimit Juridik në Kuvend, kishte një propozim që ligji të hynte në fuqi pas një periudhe, për t’i dhënë mundësi autoriteteve që të bënin aktet nënligjore. Nuk kemi ende një saktësim, një klauzolë për këtë, kështu që sugjerohet të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, siç është në tekstin aktual. Megjithatë, do të duhet që aktet nënligjore të bëhen brenda afateve që parashikon ligji. Përndryshe, zbatimi i tij, që varet edhe nga nxjerrja e akteve nënligjore, do të shtyhet, siç është në çdo ligj tjetër, ndaj këtë duhet ta zgjidhim në makro për të gjitha projektligjet që kemi.

Dakord atëherë, kolegë?

Këto ishin ndryshimet e dekretit, këto ishin amendamentet. Ne do të bëjmë një tekst integral të amendamenteve, dhe në seancë plenare do të kalojnë vetëm amendamentet. Pra, do të votohet pranimi i dekretit pjesërisht në tërësi, sipas sugjerimit të komisionit tonë, dhe nenet e amenduara sipas sugjerimit të komisionit.

Këto ishin pak a shumë!

E kërkon dikush tjetër fjalën? Jo.

Kolegë, ju falënderoj!

Po, zoti Kollçaku! Ndjesë, se nuk ju pashë!

Fjala për ju!

Bardhyl Kollçaku – Faleminderit, kryetare!

E dëgjova me vëmendje përfaqësuesin e presidencës dhe përfaqësuese e Kryeministrit. Më vjen mirë që bihet dakord, pasi ka kaluar një kohë e gjatë për këtë ligj. Vijnë tek ajo këshillë që unë dhashë edhe te Komisioni i Sigurisë dhe te Komisioni i Ligjeve, se projektligje të tilla që prekin edhe institucione të tjera duhet të konsultohen paraprakisht me institucionet që kanë tagër ose kanë edhe detyrimet kushtetuese. Jemi vonë, por më mirë vonë se kurrë

Kam një pyetje për përfaqësuesen e qeverisë: Cila ka qenë arsyeja ose logjika, sipas së cilës ligji për medaljet dhe dekoratat në Forcat e Armatosura do të rregullohet tashmë me VKM? A ka ndonjë arsye madhore, ndonjë orientim nga NATO, që nuk e dimë, që ta kuptojmë edhe ne?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Para se t'ia jap fjalën zonjës Kokona, zoti Kollçaku ky ka qenë një diskutim i zhvilluar gjerë e gjatë në komision, kur kemi bërë shqyrtimin në parim të projektligjit. Një pjesë e medaljeve dhe dekoratave janë të parashikuara në projektligjin aktual, për të cilin sot vendosëm disa amendamente për efekt të dekretit të Presidentit. Ndërkohë, një pjesë e këtyre dekoratave apo titujve, në mos gabohem, do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe siç është bërë e njohur, në grupin e punës do të jetë zoti Veliu dhe njëri nga kolegët e komisionit që dëshiron të jetë. Kjo nisur nga një praktikë e standardizuar në pothuajse të gjitha vendet e Europës në lidhje me këto çështje. Ndërsa dekoratat kryesore janë atje. Kështu që, këtë e kemi bërë në shqyrtimin në parim, zoti Kollçaku. Tani jemi për tjetër çështje, por megjithatë ju keni të drejtën tuaj.

Zonja Kokona, nëse keni një përgjigje, fjala për ju!

Elira Kokona – Faleminderit, zonja kryetare!

Siç e përmenda në fillim, zoti Kollçaku, nevoja ka qenë të unifikohemi e të ndjekim modelet më të mira të shteteve, të cilat kanë traditë në akordimin e në dhënien e dekoratave dhe të titujve. Përmbajtja e akteve ku identifikohen e përcaktohen rregullat nuk ndryshon rëndësinë e titullit e të dekoratës. Përkundrazi, është thjesht një element që ka të bëjë me aspektin procedural, thjeshtësimin e derregulimin e procedurave.

Nëse për çdo tipologji të medaljeve, titujve e dekoratave do të shkonim me akte ligjore, kjo do të krijonte një problem në eficiencën e akordimit të tyre, sepse procedura do të ishte shumë e gjatë. Për këtë arsye u krijua ai që ne e quajtmë ligj-kuadër, ligj i cili identifikon qartësisht rëndësinë e procedurës specifike të urdhrave, vendosjen e kolegjit, kancelarit. Pra, është një rregullim, i cili ndihmon në harmonizim, krijon një çadër, le të themi, ose një procedurë të përcaktuar si procedurë-kuadër. Më pas kjo detajohet me akte të tjera.

Ajo që dua të theksoj është se tipologjia e aktit që rregullon procedurën specifike nuk zhvlerëson rëndësinë e titullit apo të dekoratës, e as ndryshon rregullat e tyre procedurale. Është thjesht për teknikë legjislative dhe për eficiencë e derregulim, por dhe në ndjekje të modeleve të vendeve të tjera.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Kokona!

Kolegë, shumë faleminderit për sot! Ka qenë një ditë e lodhshme.

Zoti Rusmajli dhe stafi i presidencës, shumë faleminderit për gjithë këtë proces!

Besoj se shumë shpejt ne do t'ju paraqesim tekstin e zbardhur të secilit amendament. Edhe kolegëve të komisionit. Të enjten ky projektakt do të jetë për miratim në seancë plenare.

Kolegë, për çdo njoftim tjetër lidhur me mbledhjet e radhës do të njoftoheni!

Faleminderit të gjithëve!

Ditë të mbarë!

Mbledhja mbyllet!

MBYLLET MBLEDHJA